PROPOZIM PËR REFORMA URGJENTE DEMOKRATIKE

Shkup, korrik, 2016

PËRMBAJTJA

HYRJE 2
QASJA 3
PËRFSHIRJA, MONITORIMI DHE EVALUIMI 5
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE SIPAS KAPITUJVE 7
FINANCAT PUBLIKE DHE EKONOMIA 10
GJYQËSORI 12
LUFTA KUNDËRKORRUPSIONIT 16
ZGJEDHJET DHE SISTEMI ZGJEDHOR 21
MEDIA 26
ADMINISTRATA PUBLIKE 29
KONTROLLI MBI POLICINË DHE AGJENCITË PËR SIGURI DHE (KUNDËR)ZBULIM 34
KUVENDI 36
SHOQËRIA CIVILE 41
MBROJTJA SOCIALE, MIRËQENIA DHE QËNDRUESHMËRIA 46
ARSIMI DHE POLITIKAT RINORE 48
MJEDISI JETËSOR 52
ANEKS 1- LISTA E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE DHE EKSPERT TË PËRFSHIRË NË INICIATIVË 55
ANEKS 2 - MASA TË PROPOZUARA LEGJISLATIVE 57

HYRJE

Ky dokument paraqet një përpjekje të përbashkët të një grupi të organizatave qytetare dhe është rezultat i sinergjisë dhe bashkëpunimit mes tyre, punëtorëve shkencor dhe ekspertëve (Aneks 1). Përpjekja e këtillë e përbashkët është përgjigje e krizës aktuale politike, kthimit mbrapsh të standardeve demokratike dhe në sundimin e ligjit dhe humbjes të kredibilitetit të institucioneve.

Ky dokument është komplementar me përpjekjet e lëvizjes „#Protestoj/Revolucioni laraman" në kërkesat për reforma urgjente demokratike dhe për përfshirjen e përfaqësuesve të pavarur të shoqërisë civile në këtë proces.

Qëllimi i dokumentit është që të japë nxitje, drejtim, aktivitete të detajuara që janë të domosdoshme për kthimin e standardeve dhe vlerave demokratike, për arritjen e progresit në disa fusha nga politika publike, si dhe kthimin e besimit të qytetarëve në institucionet kryesore shtetërore. Këto fusha të politikave publike janë: financat publike dhe ekonomia; gjyqësori; lufta kundër korrupsionit; zgjedhjet dhe sistemi zgjedhor; mediat; administrata publike; kontrolli mbi policinë dhe agjencitë për siguri dhe (kundër)zbulim; Kuvendi; shoqëria civile; mbrojtja sociale, mirëqenia dhe qëndrueshmëria; arsimi dhe politikat arsimore dhe mjedisi jetësor.

Qëllimi direkt i dokumentit është që të kontribojë për krijim të kushteve të domosdoshme për zgjedhje të lira, të ndershme dhe kredibile, përmes propozimit të masave për implementimin e prioriteteve kryesore të reformës. Megjithatë, prioritet duhet t'i jepen reformave në vend të datës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Ky dokument është propozim për përpilimin e programit qeveritar për zbatimin e prioriteteve kryesore. Duke pasur parasysh rëndësinë e instrumenteve dhe masave të propozuara dhe ndikimi rrënjësor aktual i partive politike në pushtet mbi institucionet, besojme se reformat në këtë dokument duhet ti zbatojë **qeveria eksperte**.

Ekipi inicues e përpiloi këtë dokument në bazë të përvojës dhe ekspertizës shumëvjeçare në kuadër të fushave adekuate të intervenimit. Një pjesë e madhe e instrumenteve dhe masave të propozuara janë pjesë e përpjekjeve, raporteve dhe rekomandimeve të publikuara nga shoqëria civile për fusha adekuate. Megjithatë, është e nevojshme që të theksohet se kjo iniciativë nuk është pjesë e projektit formal dhe nuk është mbështetur me mjete financiare dhe/apo marrëveshje.

QASJA

Procesi i përpilimit dhe mbështetjes të përmbajtjeve nga fushat e politikave publike në këtë dokument, përveç thelbit të kësaj iniciative përfshiu numër shtesë të organizatave qytetare, punëtorëve shkencor dhe ekspertëve të pavarur[1]. Anëtarët e grupeve kryesore dhe bashkëpunëtorëve të përfshirë në fusha adekuate, janë përgjegjës vetëm për kapituj të caktuar të këtij dokumenti nëm bazë të ekspertizës së tyre.[2] Kjo qasje do të zbatohet edhe më tutje, me të gjitha organizatat qytetare dhe ekspertët që do të shprehin dëshirë që të përfshihen në kapituj/fusha të caktuara.

Çdo fushë e politikës publike në dokumentin është prezantuar përmes **parimeve dhe instrumenteve të përgjithshme, institucioneve kryesore** dhe rolit të tyre eventual, si dhe **ligjeve** të cilat duhen ndryshuar dhe propozuar[3]. Megjithatë, dokumenti përmban numër të kufizuar të masave juridike dhe fokusi i tij kryesor është për kthimin e standardeve dhe vlerave demokratike dhe depolitizim të institucioneve. Për të gjitha instrumentet e propozuara është caktuar periudhë kohore në të cilën ato duhet të zbatohen: **urgjente** (deri në 3 muaj), **afatshkurte** (deri në 6 muaj) dhe periudhë afatmesme (më shumë se 6 muaj). Ndërhyrjet në kapitullin e fundit, Mjedisi jetësor, nuk llogariten si urgjente, sepse nuk kanë lidhje me arritjen e kushteve për zgjedhje të drejta.

Gjatë 1-3 muajve të parë të periudhës kalimtare, Qeveria duhet të fokusohet kryesisht në evaluimin dhe planifikimin e të gjitha prioriteteve kryesore të reformës dhe zbatimin e masave urgjente të kontraktuara.

Gjatë gjithë procesit qeveria eksperte duhet të respektojë **parimet** e transparencës, përgjegjësisë, përfshirjes dhe efektivitetit.

Është e domosdoshme që partitë politike në **Kuvendin e RM-së** të tregojnë **përkushtim** real për zbatimin e prioriteteve kryesore të reformës. Përkushtimi i këtillë pritet edhe nga partitë jashtëparlamentare dhe te shoqëria civile në tërësi. Vullneti i fuqishëm politik dhe përkushtimi efektiv i Kuvendit, si dhe realizimi i funksionit të tij kontrollues kanë rëndësi të veçantë në zbatimin e prioriteteve kryesore të reformës. [4]

---

[2] Nëse bashkë-autorët kanë mendime të ndryshme për çështje të caktuar, kjo është e theksuar në tekst.

[3] Aneksi 2 i përmban masat e propozuara ligjore

[4] „Prioritetet kryesore të reformës" të shënuara në këtë dokument kanë të bëjnë me disa nga *Prioritete urgjente të reformës* të lëshuara nga Bashkimi Evropian më qershor 2015, të cilat bazohen në *Rekomandimet e grupit të ekspertëve me përvojë për çështje sistemike nga sundimi i së drejtës që kanë të bëjnë me ndjekjen e komunikimeve të publikuara në pranverë 2015* (a.sh.q Rapirti i Pribe-s). Megjithatë, prioritetet kryesore të reformës të shënuara në këtë dokument e kanë parasysh zhvillimin e ngjarjeve gjatë vitit të fundit dhe janë përpiluar në masa më specifike në fushat adekuate ku autorët kanë ekspertizë.

Përveç kësaj, edhe institucionet kompetente në pushtetin gjyqësor, trupat e pavarura mbikëqyrëse dhe rregullative duhet të tregojnë përkushtimin e tyre ndaj zbatimit të prioriteteve kryesore të reformës.

Gjithashtu, është e domosdoshme që masat e marra të drejtohen në përmirësimin e kohezionit social të qytetarëve dhe të të gjitha komuniteve etnike. Në këtë drejtim, është e nevojshme që të shqyrtohen rekomandimet nga Rishikimi i Marrëveshjes së Ohrit për kohezion social nga viti 2015[5].

Që të sigurohet zbatimi dhe bashkëpunimi efikas i të gjitha palëve të prekura, propozojmë zbatimin e këtyre instrumenteve:

- ndryshimi i planeve strategjike të ministrive dhe organeve të tjera me qëllim të harmonizimit të tyre me prioritetet e Qeverisë dhe sigurimit të monitorimit të rreptë të zbatimit;
- formimi i ekipeve (ekspertë, këshilltarë, punonjës) në të gjitha ministritë me qëllim zbatimin e këtij dokumenti dhe evaluim të mëtutjeshëm të gjendjes;
- formimi i trupave koordinuese ndërsektoriale aty ku është e nevojshme, të përbëra nga përfaqësues prej të gjitha institucioneve të përfshira në procese të ndryshme të zbatimit të këtij dokumenti (për shembull për pastrimin e Listës zgjedhore);
- publikim i obligueshëm i të gjitha konkluzioneve nga seancat e Qeverisë, përfshirë edhe vendimet, konkluzionet dhe aktet tjera që nuk publikohen në Gazetën zyrtare të RM-së (në afat prej 24 orë në web faqen e Qeverisë);
- fillimi i fushatës mediatike, e ndjekur me aktivitete në nivel të ministrive dhe institucioneve/agjencive shtetërore, me qëllim që të përmirësihet kohezioni dhe sinergjia mes punonjësve, pa dallim përkatësia e tyre politike apo etnike;

Jemi të vetëdijshëm për faktin se neglizhenca shumëvjeçare të prioriteteve adekuate në sektorin publik dhe fokusimi i buxhetimit, në vend të rezultatit të ministrive solli deri në joefikasitet, mungesë të procedurave, vendime kontradiktore ligjore, mungesë të punonjësve në disa sektore të administratës (ndërsa njëkohësisht të mbipunësuar në të tjera) dhe përfundimisht, në përkeqësimin e shërbimeve publike. Gjithashtu, jemi të vetëdijshëm për faktin se disa sektorëve u nevojiten resurse shtesë (jo gjithmonë financiare) me qëllim të sigurimit të shërbimeve publike efikase dhe efektive. Për këtë arsye propozojmë qasje me parime dhe prioritete, me qëllim të respektimit të efikasitetit të përgjithshëm të sektorit publik, në vend të qasjes të sektorëve që luftojnë për resurse financiare.

Gjithashtu theksojmë se është e nevojshme që të fillojnë përgatitje për zbatim të regjistrimit të popullsisë.

[5] E disponueshme në: http://www.siofa.gov.mk

PËRFSHIRJA, MONITORIMI DHE EVALUIMI

Për zbatim të plotë të këtyre reformave, është i nevojshëm vlerësim paraprak i situatës që do të bazohet në të dhëna zyrtare dhe reale në të gjiha fushat që janë subjekt i këtij dokumenti. Me rëndësi të veçantë është që sektori civil të përfshihet në procesin e vlerësimit të situatës aktuale, si dhe në monitorimin dhe evaluimin e progresit në zbatimin e prioriteteve kryesore të reformave.

Me rëndësi të veçantë është që sektori civil të përfshihet në procesin e monitorimit dhe evaluimit të prioriteteve kryesore të reformës. Është e nevojshme që të sigurohet pjesëmarrje civile edhe në nivel ekzekutiv dhe në atë ligjvënës, përfshirë edhe bashkëpunimin me gjyqësorin dhe trupat e pavarura kontrolluese dhe rregullative.

- Duhet të formohet Këshill konsultativ për implementimin e prioriteteve kryesore të reformës në nivel qeveritar me të cilin do të udhëheq kryetari i Qeverisë dhe që do të përbëhet nga përfaqësues të ministrive kompetente dhe shoqërisë civile;
  - Në kuadër të këtij Këshilli duhet të formohen grupe tematike të përbëra nga organizata qytetare, shoqata joformale qytetare, tink-tenqe, iniciativa joformale, sindikata etj., me qëllim që të mbështeten konsultimet,
  - monitorimi dhe evaliuimi i prioriteteve kryesore të reformës;
- Emërimi i personave për kontakt në ministritë dhe trupat e pavarura mbikëqyrëse dhe rregullative që do të jenë përgjegjës për prioritete kryesore të reformës dhe që gjithashtu do të jenë të obliguar për bashkëpunim me grupet tematike të shoqërisë civile;
- Trupat kompetente parlamentare duhet të mbajnë debate mujore publike për implementimin e prioriteteve kryesore të reformës që janë nën kompetencat e tyre. Në këto debate duhen ftuar edhe përfaqësues të shoqërisë civile me përvojë të dëshmuar në fusha adekuate. Ky aktivitet i përfshin këto komisione (lista nuk është e shfletuar):
  - Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie mes bashkësive;
  - Komisioni për financim dhe buxhet;
  - Komisioni për transport, lidhje dhe ekologji;
  - Komisioni i përhershëm anketues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarit;
  - Komisioni për mbikëqyrjen e punës së Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe të Agjencisë së zbulimit
  - Komisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të masës së veçantë hetuese ndjekja e komunikimeve nga Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria Doganore dhe Ministria e Mbrojtjes;
  - Përveç kësaj, Këshilli nacional për eurointegrime si dhe komisioni për çështje evropiane duhet të mbajnë mbledhje mujore kushtuar zbatimit të prioriteteve kryesore të reformës, në bazë të raporteve

të parashtruara nga Qeveria dhe nga trupat e pavarura mbikëqyrëse dhe rregullative edhe pas diskutimeve në komisionet amë parlamentare.

Ekipi iniciues do të përkushtohet që të kontribojë drejt diskutimeve të mëtejshme për mënyrat e përfshirjes së shoqërisë civile në proces.

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE SIPAS KAPITUJVE

FINANCAT PUBLIKE DHE EKONOMIA: Masat e propozuara bazohen në kthimin e disiplinës fiskale dhe vendosjes së transparencës fiskale.

GJYQËSORI: Duhet ndryshuar ligjet për përgjegjësinë efektive të anëtarëve të Këshillit gjyqësor. Kjo duhet mbështetur me transparencë adekuate për punën e Këshillit gjyqësor dhe Këshillit të prokurorëve publikë. Gjykatat dhe Prokuroria Publike medoemos duhet të jenë më të hapur për organizatat qytetare dhe qytetarët. Prokuroria Speciale Publike (PSP) patjetër duhet të vazhdojë me punë, ndërsa institucionet duhet të bashkëpunojnë dhe t'i dorëzojnë të gjitha informacionet që i nevojiten PSP, në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë penale. Nevojiten aktivitete për informimin e qytetarëve për të drejtat e tyre, si plotësim të vendosjes së mekanizmave adekuate për mbrojtjen e tyre.

LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT: Në fillim më me rëndësi është që përsëri të vendosen institucionet për luftë kundërkorrupsionit përmes locimit të përgjegjësisë për joefikasitetin e tyre në periudhën e kaluar dhe t'u mundësohet që në mënyrë efektive t'i zbatojnë këto autorizime. Po ashtu nevojitet caktimi i mekanizmave adekuate për zvogëlimin e rrezikut për korrupsion, me fokus në fushat kyçe, si për shembull inspektoratet, furnizimet publike, punësimet, punës financiare dhe transparencës së financimit të partive politike.

ZGJEDHJET DHE SISTEMI ZGJEDHOR: Vazhdimi i reformimit të Komisionit Shtetëror Zgjedhor, pastrimi i Listës zgjedhore dhe veçimi i shtetit nga partitë politike. Mes tjerash, propozohet tejkalimi i disa dobësive afatgjate të zgjedhjeve dhe të sistemit zgjedhor që kanë të bëjnë me zgjedhjen e deputetëve, votimin jashtë vendit dhe rregullimin e fushatës zgjedhore.

MEDIAT: Intervenimet kryesore për tejkalimin e dobësive sistematike të fokusuara për: pavarësi të plotë të trupit regullativ nga ndikimi politik, indrustrisë mediatike dhe qendrave të tjera të fuqisë; sigurim të pavarësisë së mediave mainstream komerciale nga funksionarët qeveritarë dhe partiakë; autonomi institucionale dhe pavarësi të Servisit publik radiodifuziv; rritje të nivelit të transparencës të institucioneve publike; refuzim të fjalës së urrejtjes dhe diskriminim në media; rritje të nivelit të sigurisë së gazetarëve.

ADMINISTRATA PUBLIKE: Masat janë fokusuar në përforcimin e sistemit të meritave në punësim dhe avancim në karierë në kuadër të administratës publike; kthim të besimit në institucione; sigurim të veçimit mes shtetit dhe partive politike; sigurim të qasjes së plotë në informacione me karakter publik; sigurim të barazisë dhe sigurisë juridike në procedurat administrative; shqiptimi i gjobave duhet të bazohet në proporcionalitet; eliminim të shkarkimeve

arbitrare në administratën publike; sigurim të efektivitetit të administratës publike;

KONTROLLI MBI POLICINË DHE AGJENCITË PËR SIGURI DHE (KUNDËR)ZBULIM: Parimet kryesore janë: të sigurohet kontroll i jashtëm civil kredibil dhe efektiv mbi policinë dhe shërbimet sekrete; mekanizmi i ardhshëm për kontroll të jashtëm mbi policinë do të përfshijë anëtarë të organizatave qytetare, universiteteve, prokurorive publike dhe nëpunës policie të pensionuar – në bazë të barabartë, me përgjegjësi dhe obligime të barabarta; vendosje të policëve rajonalë; përforcim të kontrollit parlamentar mbi policinë dhe agjencitë për zbulim.

KUVENDI: Kuvend medoemos duhet të jetë më transparent ndaj publikut dhe të mundësojë përfshirjen e palëve të prekura nga fusha të ndryshme të politikës publike. Kuvendi duhet t'i ndryshojë procedurat për miratimin e ligjeve dhe medoemos duhet të zhvillojë praktikë të respektimit të Rregullores, me qëllim që të jetë forum efektiv ku në mënyrë thelbësore do të shqyrtohen ligjet e propozuara. Përforcimi dhe funksionimi adekuat i mekanizmave për kontroll mbi Qeverinë duhet të rezultojë me pushtet mëpërgjegjës.

SHOQËRIA CIVILE: Shoqëria civile në procesin e hartimit të poltikave dhe në procesin politik duhet të përmirësohet nëpërmjet: vendosjes së financimit publik, transparent dhe publik të shoqërisë civile dhe zhvillimit të tij; revidimit thelbësor të Strategjisë për bashkëpunim me sektorin civil të Qeverisë së RM-së, si dhe të dokumenteve të caktuara operative (vendime dhe rregullore) dhe struktura (Këshilli për bashkëpunim); përforcimit të demokracisë së drejtpërdrejtë dhe shoqatave qytetare joformale përmes nxitjes së referendumeve lokale, iniciativave ligjvënëse dhe peticioneve; vendosjes së mekanizmit efektiv konsultues për hartimin e politikave dhe miratimin e ligjeve me garancë për përfshirje të qytetarëve në të gjitha fazat e hartimit të politikave.

MBROJTJA SOCIALE, MIRËQENIA DHE QËNDRUESHMËRIA: Për ballafaqim me varfërinë, pabarazinë dhe sfidat me mjedisin jetësor është e nevojshme të shqyrtohen gabimet e sistemit aktual dhe është i nevojshëm përkushtim drejt përgatitjes së strategjive të cilat në mënyrë adekuate do ta trajtojnë varfërinë, pabarazinë, ndotjen, çështjet etnike dhe/ose çështje të tjera përmes qasjes ndërsektorale. Aktivitetet urgjete duhet të fokusohen në monitorim „në vendngjarje" të procedurave për alokim të transfereve sociale me qëllim që të sigurohet që transferet sociale jepen në mënyrë të paanshme dhe pa pengesa, në përputhje me ligjin.

ARSIMI DHE POLITIKAT RINORE: Revidimi i ligjeve për arsim që do të mundësojë tërheqje të testimit ekstern dhe dënimit të mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve, demokratizim të udhëheqjes me shkollat dhe zgjedhjen

e drejtorëve dhe mësimdhënësve; tërheqje të Ligjit për akademi për mësimdhënës, reformë të planprogrameve dhe librave dhe reformë të trajnimit dhe ritrajnimit fillestar të mësimdhënësve; futjen e qasjes së integruar në kontrollin e cilësisë në arsim; ndërprerje të zgjerimit të mëtejshëm dhe disperzimit të institucioneve të arsimit të lartë; përmirësim të organizimit studentor dhe participimit në shkollat e mesme dhe të larta; përgatitje të ligjit të ri për arsimin e lartë nga e gjithë shoqëria akademike; revidim të Strategjisë nacionale për të rinj 2016-2025 para përgatitjes të çfarëdo plan të veprimit.

MJEDISI JETËSOR: Fokusi është në ndryshimet e nevojshme sistematike për të mundësuar përdorim adekuat të taksave ekologjike, me qëllim që të mbrohet mjedisi jetësor dhe implementim të ligjit në Bashkimin Evropian. Ndryshimet e propozuara do të rezultojnë me mbrojtje të mjedisit jetësor dhe përmirësim të cilësisë së jetesës në Republikën e Maqedonisë.

FINANCAT PUBLIKE DHE EKONOMIA

HYRJE

Ekzistojnë dyshime që financat publike shfrytëzohen në mënyrë jo transparente. Kjo është rezultat i mungesës së transparencës adekuate fiskale dhe disiplinës fiskale, që çon deri në ad-hoc vendime fiskale.

PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet e përgjithshme për aktivitetet e propozuara janë:

- kthimin e disiplinës fiskale;
- krijimin e transparencës fiskale;
- pa ndryshime në strukturën e sistemit për financa publike (ndryshimet në sistemin për financa publike duhet të lihen për qeverinë e ardhshme, e cila mandatin do ta fitojë përmes zgjedhjeve);

AKTIVITETE DHE INSTITUCIONET KYÇE

Këto aktivitete duhet të zbatohen nga Ministria për financa në periudhë prej 3 muaj:

- **ribalanc të Buxhetit të RM-së për vitin 2016,** duke i marrë parasysh masat e propozuara në këtë dokument;
- **publikim i planeve buxhetore dyjavore (ose mujore) dhe raporte për ekzekutimin e buxhetit.** Këto plane dhe raporte duhet të jenë shumë më analitike se deri më tani dhe duhet të jenë të disponueshme për publikun;
- **vendosjen e kontrollit mbi huamarrjen e qeverisë.** Atëherë kur qeveria do të ketë nevojë të marrë hua më tepër se ajo që është parashikuar në planet, duhet publikisht dhe në mënyrë transparente të sqarohet se për çfarë qëllimi do të shpenzohen mjetet e huazuara;
- **vlerësim të detyrimeve të papaguara në bazë të TVSH-së dhe bazave të tjera** për gjithë sektorin publik (qeverinë, komunat, fondet dhe ndërmarrjet publike), publikim i listës dhe përgatitje të planit transparent për pagesën e tyre;
- Përfundim i **pagesave selektive** të shpenzimeve aktuale;
- **vlerësim i projekteve kapitale të qeverisë** dhe publikim i strukturës së tyre sipas fazës së implementimit (planifikimi, faza aktuale dhe përfundimtare). Duhet t'u jepet prioritet projekteve të cilat për shkak të natyrës së tyre dhe/ose qëllimit të tyre nuk mund të ndalen;
- **vlerësim i procesit të prokurimit publik,** duke i dhënë prioritet projekteve të cilat për shkak të natyrës së tyre dhe/ose qëllimit të tyre nuk mund të ndalen.

Masa plotësuese për përmirësim të transparencës fiskale dhe qeverisje të mirë

Këto aktivitete mund të zbatohen në bashkëpunim me organizatat qytetare dhe ekspertë. Aktivitetet duhet të fillojnë gjatë 3 muajve të parë, por mund të jetë e nevojshme të zgjasin më shumë deri sa të përfundojnë. Pavarësisht kohës së nevojshme për implementimin e tyre, është e nevojshme që këto masa të fillojnë, të cilat do të jenë të shoqëruara me kuadër përkatës për monitorim, i cili do të sigurojë publikim të raporteve të rregullta për publikun në lidhje me fazat e implementimit të këtyre masave.

- publikim të shumës totale të borxhit publik (përfshirë edhe detyrimet e papaguara dhe borxhet e komunave) për disa vite të kaluara;
- publikim i numrit të të punësuarve në sektorin publik për më tepër vite të kaluara;
- vlerësim dhe publikim të implikimeve buxhetore të projektit „Shkupi 2014" për çdo vit, struktura, konstruksioni financiar dhe mjetet e ndara financiare;
- vlerësim i kostove dhe përfitimeve nga investimet direkte të huaja;
- vlerësim i kapacitetit fiskal dhe qëndrueshmërisë të sistemit pensional, përfshirë edhe punën e MAPAS;
- vlerësim i qëndrueshmërisë dhe transparencës së subvencioneve bujqësore, me theks të veçantë në ndarjen e tyre;
- vlerësim i qëndrueshmërisë, transparencës dhe efektet distributive të transfereve sociale;
- vlerësim i efekteve distributive të politikave tatimore.

GJYQËSORI

HYRJE

Prioritetet urgjente për reforma (PUR) në fushën e gjyqësorit, të cilat të propozuara nga Komisioni Evropian në qershor të vitit 2015[6], nuk janë zbatuar në mënyrë konsistente. *Si zëvendësim për reformat ofrohet vetëm si 'ambalazhë e butë e reformës', e cila e plotëson formën, por jo edhe thelbin. Zbatohen vetëm aspekte të veçanta teknike, të cilat kanë ndikim të kufizuar mbi pavarësinë dhe profesionalizmin e pritur*."[7] Kjo gjë gjithashtu, është konfirmuar prej hulumtimeve të prioriteteve të veçanta në fushën e gjyqësorit, gjë që tregon që janë ndërmarrë aktivitete që janë në kundërshtim me prioritetet urgjente të reformave[8].

PARIMET E PËRGJITHSHME

Në periudhën në vijim, roli i gjyqësorit duhet të përforcohet në disa aspekte kyçe. E para, Prokuroria publike speciale (PPS) duhet të vazhdojë pa pengesë me punë, kurse organet përgjegjëse shtetërore duhet të bashkëpunojnë me të dhe t'ia sigurojnë të gjitha informacionet dhe dëshmitë që i nevojiten për udhëheqje pa pengesë të procedurës, në përputhje me predispozitat e Kodit të procedurës penale. E dyta, duhet të sigurohet transparencë adekuate në funksionimin e Këshillit gjyqësor dhe Këshillit të prokurorëve publik. E treta, duhet të ndërmerren të gjitha aktivitetet për informim të qytetarëve për të drejtat e tyre, të pasuara nga krijimi i mekanizmave për mbrojtjen e tyre, në mënyrë që hap pas hapi të kthehet besimi i qytetarëve në institucione.

Konkretisht, kjo mund të bëhet përmes aktiviteteve në vijim:

- Duhet të ndryshohet dhe të plotësohet Ligji për mbrojtje të dëshmitarëve me qëllim që t'i mundësohet PPS-së që pa pengesë dhe në mënyrë efikase ta përdorë instrumentin e dëshmitarit të mbrojtur në rastet që janë nën kompetencat e saj;
- Duhet të formohet një njësi e veçantë në kuadër të Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim (në përputhshmëri me nenet 22-31 nga Ligji për punë të brendshme) e cila do të ketë qasje në resurset dhe pajisjet e njejta si Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim, me qëllim që t'i përgjigjen kërkesave për masat parahetimore të dorëzuara nga PPS.
- Duhet të sigurohet pavarësi financiare dhe qëndrueshmëri të PPS-së, me çka PPS do të bëhet përdorues i pavarur i buxhetit. Qeveria nuk duhet në

[6] http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_urgent_reform_priorities.pdf
[7] Institute for European Policy, *The Urgent Reform Priorities slower than the reinstalling of the non-reformation practices!* Available at: http://epi.org.mk/docs/Realizacija%20na%20Itnite%20reformski%20prioriteti.pdf.
[8] Macedonia – EU Resource Center (MERC 23), *The status of the realization of the Urgent Reform Priorities*. Available at: http://www.merc.org.mk/status-na-realizacija-na-itni-reformski-prioriteti

asnjë mënyrë të luaj rol ose të ndërhyjë gjatë miratimit të buxhetit për këtë institucion;

- Prolongim të afatit aktual për ngritje të padisë për lëndët e marra nga PPS nga prokurorët e rregullt publik nga 18 në 24 muaj (Neni 22) ;
- Transformim të PPS-së në trup të përhershëm (për më tepër detaje, shiko në pjesën për antikorrupsion);
- Duhet të përforcohet pavarësia e Këshillit gjyqësor të RM-së përmes emërimit të anëtarëve të rinj nga rradhët e gjykatësve, duke u lejuar që të vazhdojnë t'i kryejnë detyrimet e tyre me qëllim që mos ta humbin kontaktin direkt me aspektet praktike të drejtësisë. Me qëllim që të sigurohet ekspertiza dhe kompetenca e këtyre anëtarëve të Këshillit të cilët nuk janë gjykatës, është e nevojshme të propozohet kriter plotësues për anëtarësimin e tyre, i cili do të jetë i lidhur me përvojën dhe arritjet e tyre profesionale. Me këtë, do të ishte e pëlqyeshme që anëtarët të cilët kanë qenë avokatë të zgjidhen nga Kuvendi, me propozim të Odës së Avokatëve të RM-së, pasi paraprakisht do të zgjidhen me votim nga ana e të gjithë anëtarëve. Zgjedhja e anëtarëve të rinj të Këshillit gjyqësor është i nevojshëm që të zbatohet zgjedhje e pavarur e gjykatësve në njësinë e veçantë të sapoformuar në kuadër të Gjykatës Themelore Shkup 2 ;
- Duke i patur parasysh pengesat e dukshme ndaj PPS-së nga gjyqësori I politizuar, është i nevojshëm krijimi i një njësie të specializuar gjyqësor I cili do të veprojë mbi lëndët të cilat i udhëheq PPS. E njejta mund të vendoset përmes ndryshimeve në Ligjin actual për gjykatës ose me të ligj të ri, të veçant që ketë të bëjë me funksionimin e kësaj njësie, dhe do të ketë kompetenca për veprim pas veprave penale lidhur me dhe që rezultojnë nga përgjimi joligjor. Këshilli i sapozgjedhur gjyqësor do të duhet publikojë shpallje për gjykatës të cilët do të zgjidhen që të punojnë në këtë njësi. Kriteret për zgjedhje të këtyre gjykatësve do të duhet të përforcohen në aspekt të integritetit, pavarësisë dhe paanshmërinë e kandidatëve. Ky proces duhet të shoqërohet paraprakisht me një debat të gjerë dhe proces konsultativ me të gjitha palët, posaçërisht me organizatat e shoqërisë civile.
- Përforcim të kritereve veçmë të vendosura për zgjedhje të anëtarëve të Këshillit të prokurorëve publik nga ana e Kuvendit (4 anëtarë) nga rradhët e "avokatëve eminent";
- Duhet të sigurohet një mjet i pavarur dhe efektiv juridik për ata kandidatë të cilët do të jenë të pakënaqur nga zgjedhja, për ata të cilët do t'i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore, si dhe procedurës për shkarkim të gjykatësve;
- Duhet të përpunohen ndryshimet dhe plotësimet e pregatitura të KPP;
- Urgjentisht duhet të qasemi drejt krijimit të qendrave hetimore të prokurorisë publike në përputhje me KPP;
- Personat të cilët e konsiderojnë veten si viktima të procedurave politike dhe për të cilët është sjellë aktgjykim i plotëfuqishëm, duhet tu

mundësohet t'a shfrytëzojnë mjetin e jashtëzakonshëm ligjor „Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë" para Gjykatës Supreme, siç është paraparë në Ligjin për procedurë penale (nenet 457-462). Prokurori publik duhet t'i përcjellë kërkesat e këtilla deri te Gjykata Supreme sipas procedurës zyrtare.

- Më së paku 5 deri 9 vende të lira duhet të plotësohen në Gjykatën Supreme. Gjykatësit e rinjë, të emërtuar nga ana e Këshillit gjyqësor të pavarur, duhet t'a përforcojnë Njësinë penale në kuadër të Gjykatës Supreme. Njësia penale plotësisht funksionale do të mund të vendosë për të gjitha kërkesat e dorëzuara nga viktimat e pretenduar. Gjykata Supreme do t'i marrë parasysh opinionet e pavarura të përfaqësuesve të akademisë/ekspertëve dhe organizatave qytetare;
- Strategjia për gjyqësorin duhet të miratohet pas një procesi të gjërë konsultativ dhe diskutim me ekspertë në lidhje me novitetet/modalitetet e propozuara, në mënyrë që të zgjidhen çështjet kyçe në gjyqësor;
- Duhet të ndryshohen kriteret për regjistrim në Akademinë për gjykatës dhe prokurorë publik, në mënyrë që Akademia të bëhet më e disponueshme dhe më tërheqëse për kandidatët potencial, si dhe për zvogëlim të mundësive për çfarë do lloj ndërhyrjesh politike ose ndërhyrje tjera në këtë proces;
- Duhet të rritet buxheti për gjyqësorin përmes alokimit të resurseve adekuate, në përputhje me Ligjin për buxhetin gjyqësor;
- Gjykata Supreme duhet t'a përshpejtojë procedurën për instalimin e një baze të të dhënave të vendimeve gjyqësore dhe të kërkojë mundësi për t'i transferuar në bazën qendrore të të dhënave;
- Gjykata Kushtetuese duhet të fillojë të sjellë vendime meritore me të cilat do të shkurtohen procedurat administrative dhe do të mbrohen të drejtat e qytetarëve;

INSTRUMENTE

- ndryshim dhe plotësim të Ligjit për mbrojtje të dëshmitarëve (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 38/2005 и 58/2005);
- ndryshim dhe plotësim në ligjin për Prokurorinë publike speciale[9](Gazeta zyrtare e RM-së nr. 159/2015) me qëllim zgjatje të afatit aktual për ngritje të padisë për lëndët e marra nga PPS, prej 18 në 24 muaj (neni 22). Janë të nevojshme ndryshime plotësuese që të sqarohet që afati prej 24 muajsh nuk ka të bëjë me rastet e reja të mundshme që do të dalin ose që janë të lidhura me përgjimin e paligjshëm të komunikimeve (neni i ri 22-a, paragrafi 1). Për raste të këtilla, afati për ngritje të padisë duhet të jetë 18 muaj dhe duhet të fillojë të rrjedhë pasi prokuroria ka ngritur hetim (neni i ri 22-a, paragrafi 2);

[9] Ligji për Prokurorinë publike për ndjekje të veprave penale lidhur dhe që rezultojnë nga përmbajtja e përgjimit të paligjshëm të komunikimeve

- ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, veçanërisht nenet 11, 26, 28 dhe 32 (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 60/2006, 69/2006, 150/2010, 100/2011, 20/2015 dhe 61/2015);
- ndërprerje e Ligjit për Këshillin për verifikim të fakteve dhe ngritje të procedurës për vërtetim të përgjegjësisë për gjykatës (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 20/2015);
- ndryshim dhe plotësim të Ligjit për gjykatësit, neni 45 (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 61/2008, 118/2008, 16/2009, 150/2009, 150/2010 dhe 39/2012), por gjithashtu ndryshime me të cilat do të formohet njësi e veçantë në kuadër të Gjykatës Themelore Shkup 1 – Shkup, e cila do të jetë përgjegjëse për veprat penale lidhur dhe që rezultojnë me përgjimin e paligjshëm të komunikimeve;
- ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Këshillin e prokurorëve publik (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 150/2007 dhe 100/2011) me qëllim që të për përforcim të kritereve veçmë të vendosura për zgjedhje të anëtarëve të Këshillit të prokurorëve publik nga ana e Kuvendit (4 anëtarë) nga rradhët e "avokatë eminent";
- ndërprerje e Ligjit për vendosje dhe përcaktim të kohëzgjatjes së dënimit (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 199/2014);
- ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Akademinë për gjykatës dhe prokurorë publik, veçanërisht neni 57 (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 20/2015, 192/2015 dhe 231/2015);

INSTITUCIONET KYÇE DHE ROLI I MUNDSHËM I TYRE

Në mënyrë që të implementohet masat e propozuara, është e nevojshme pjesëmarrje e të gjitha palëve të tanguara në fushën e gjyqësorit, e veçanërisht Këshillit gjyqësor, Këshillit të prokurorëve publik, Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik, Ministrisë së drejtësisë, Kuvendit, si dhe organizatat qytetare dhe ekspertë me përvojë të pasur në fushën e gjyqësorit.

LUFTA KUNDËRKORRUPSIONIT

HYRJE

Skandali me përgjimet nga viti 2015 vërtetoi se gjendja politike në Maqedoni është në formë "të shtetit të bllokuar" – institucionet publike janë përvetësuar në dobi të interesave private të një ose më shumë elitave me qasje në fuqinë politike. Me fjalë të tjera – korrupsion në nivel më lartë. Në kontekstin ekzistues ky "bllokim" është bërë në partitë e koalicionit në pushtet. Institucionet në dy mënyra u përgjigjën pa sukses për këtë sfidë: pasuksesshmëri për të penguar realizimin e gjendjes së tillë "të pushtetit të bllokuar" dhe pasuksesshmëri që të veprohet për infomracione që u zbualuan nga inçizimet e përgjimit. Kjo do të thotë se institucionet që është dashur të jenë të pavarura, në masë të madhe janë të varura nga vullneti politik për luftën kundërkorrupsionit.

PARIME TË PËRGJITHSHME

Objektivat kryesore për afatin urgjent dhe të mesëm është që përsëri të vendoset roli i palëve të prekura në luftën kundërkorrupsionit dhe t'u mundësohet që në mënyrë efikase të realizojnë kompetencat dhe funksionet e tyre. Që do të thotë, ndryshim në legjislacion, politikë dhe të nëpunësve dhe funksionarëve që do të sigurojë:

- Reformën në sistemin e financimit të partive politike;
- Vendosjen e përsëritur të llogaridhënjes dhe përgjegjësisë në institucionet për luftën kundëkorrupsionit si Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) dhe Prokuroria publike për krim të organizuar dhe korrupsion (PPKOK);
- Kompetencën dhe integritetin e njerëzve që do të kenë si obligim zbatimin e këtyre aktiviteteve, kryesisht në KSHPK dhe PPKOK;
- Institucionet do të kenë resurse adekuate njerëzore dhe financiare;
- Përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në vëzhgimin e furnizimeve publike dhe punësimeve në administratë;
- Përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në vëzhgimin e aktiviteteve kundërkorrupsionit të KSHPK dhe PPKOK;
- Kompetenca shtesë të KSHPK për ndjekjen më të mirë të listave anketuese të të emëruarve dhe personave të zgjedhur për konflikt të mundshëm të interesit sipas modelit të ngjashëm me Agjencinë për integritet nacional të Rumanisë;
- Mekanizmin efektiv për mbrojtjen e denoncuesve.

INSTRUMENTET

Urgjente

- ➢ Përmirësimi i kritereve për anëtarët e KSHPK – duke përfshirë fokus të përvojës dhe ekspertizës në vend të arsimit dhe debatit publik në Kuvend ku organizata qytetare me përvojë të dëshmuar do të mund t'i dëgjojnë kandidatët si pjesë e procesit të zgjedhjes;
- ➢ Kuvendi e shkarkon përbërjen ekzistuese e KSHPK;
- ➢ Kuvendi kërkon dorëheqje dhe përgjegjësi të anëtarëve të: Këshillit gjyqësor, Këshillit të prokurorëve publikë, Prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë dhe udhëheqësit të PPKOK;
- ➢ Përbërja e re e KSHPK publikon të dhëna historike (si të dhëna me karakter të hapur) dhe ndryshime në gjendjen e listave anketuese të personave të zgjedhur dhe të emëruar dhe e përhap vëllimin e informacioneve që i publikon;
- ➢ Realizimi i vlerësimeve të rreziqeve nga korrupsioni dhe hartimi i planeve për integritet në institucione kryesore. Këto institucione janë: Ministria e punëve të brendshme, Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim, të gjitha inspektoratet si dhe të gjitha institucionet që ofrojnë ndihmë dhe subvencione si dhe ato që grumbullojnë të ardhura. Në bazë të rekomandimeve nga planet për integritet, në afat mesatar këto institucione do të duhet t'i plotësojnë boshllëqet e rregullores dhe të zhvillojnë mekanizma shtesë të kontrollit ku janë identifikuar rreziqet;
- ➢ Vendosja e moratoriumit të furnizimeve publike jooperative deri në realizimin e zgjedhjeve;
- ➢ Byroja e furnizimeve publike (BFP) u lejon qasjen e organizatave qytetare që në vendngjarje ta vëzhgojnë punën e Komisionit për furnizime publike. Mës tjerash, të sigurojë që institucionet ta publikojnë dokumentacionin e plotë të ofruesve që të ndihmohet vëzhgimi i qytetarëve;
- ➢ BFP t'i publikojë të gjitha të dhënat për furnizimet publike si të dhëna të hapura që t'u mundësohet organizatave qytetare të hulumtojnë ekzistimin e rrjeteve klienteliste;
- ➢ Publikimi i domosdoshëm i informacioneve për shpenzimin e buxhetit të të gjitha ministrive dhe organeve në portalin e BFP. Publikimet duhet të ndahen si lëndë dhe si furnizues;
- ➢ Ndryshimi i Ligjit për furnizime publike që në të ardhmen çdo furnizim patjetër duhet që paraprakisht të ketë një vijë të caktuar buxhetore;
- ➢ Agjencia për administratë t'u japë qasje OQ-ve për vëzhgimin e procesit të punësimit dhe testimit të administratës;
- ➢ Të krijohet një grup pune ndërmjet KSHPK, Drejtoria e të hyrave publike (DHP) dhe Enti shtetëror për revizion (ESHR) që të hulumtohet financimi i partive politike dhe shpenzimi në tre vitet e kaluara. Metodologjia, konstatimet dhe rekomandimet për hapat e rradhës duhet konsultuar me OQ (me përvojë të konstatuar në fushën e financimit të partive politike) në më shumë faza të përpilimit të analizës dhe hulumtimit për të siguruar

transparencë dhe llogaridhënje se procedurat që do të nisin për shkak të konstatimeve do të zbatohen:

- ➢ Revizioni i domosdoshëm vjetor të partive politike;
- ➢ Emërimi i anëtarëve të rinj të Komisionit për mbrojtje të së drejtës për qasje në informacion të karakterit publik. Ata duhet të jenë ekspertë të pavarur me përvojë të gjërë në fushën e qasjes në informacione;
- ➢ Ndalimi për dorëheqje blanko të personave të zgjedhur dhe të emëruar. Ndalimi për vlefshmërisë së premtimpagesave të personave të zgjedhur dhe të emëruar që i bëjnë të varur nga partitë politike ose nga patronët e tyre politikë. Vendosja e sanksioneve për praksë të këtillë duhet përfshirë në Kodin zgjedhor. Këto sanksione duhet të përfshijnë edhe ndalimin në pjesëmarrje të zgjedhjeve të ardhshme;
- ➢ Ligji për mbrojtjen e denoncuesve duhet ndryshuar për të mos lejuar mundësi që gjykatat në cilido moment të mund ta zbulojnë identitetin pa pëlqim paraprak, rritje të specifikimeve teknike që sigurojnë anonimitet të denoncuesve në çdo kohë. Më me rëndësi është që të përfshihet klauzolë e përgithshme për denoncimin e prokurorisë publike që të mund të përfshihet Prokuroria speciale në listën e organizatave për denoncim të jashtëm.

Afatshkurtër

- ➢ Vendosja e sistemit për financim të partive politike vetëm nga mjete publike dhe ndalimi për çfarëdolloj donacione private. Të gjitha partitë të regjistruara politike do të marrin shumë të njëjtë themelore të mjeteve, ndërsa mjete shtesë do të marrin proporcionalisht me numrin e vendeve (ose vendeve përfaqësuese në këshillat komunalë) të deputetëve;
- ➢ Mendimi i ndryshëm për financimin e partive politike: Vendosjen e mekanizmit ku ka kontroll të domosdoshëm të prejardhjes së mjeteve për çdo donacion dhe rritje të tatimit për donacione të partive politike. Qëllimi i kësaj është që të rriten të ardhurat publike për intervenime në fusha të tjera të interesit publik;
- ➢ Vendosja e kontrollit të domosdoshëm tatimor dhe informimit publik për çdo donacion të personave fizikë dhe juridikë për partitë politike;
- ➢ Masa për furnizime publike:
  - a. Tërheqja e Neneve nga Ligji që e themelon Këshillin për furnizime publike dhe shpërbërja e anëtarëve të Këshillit;
  - b. Revidimi i të ashtuquajturave referenca negative të kompanive;
  - c. Të rimendohet përdorimi i çmimit më të ulët si kriter i vetëm. Sipas direktivës së BE "oferta më e volitshme ekonomike" është caktuar si kriter kryesor i përbër nga më shumë

elemente, ku përveç çmimit, qëndrojnë edhe cilësia dhe pagueshmëria e çmimit.

- Masa për qasje të lirë në informacione:

  a. Të mundësohet që Komisioni për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë në informacione të karakterit publik (MDQLIKP) të ngre procedurë kundërvajtëse për posedues të informacioneve që nuk veprojnë sipas kërkesave;

  b. Të vendosen kompetenca për publikimin dhe deklasifikimin e informacioneve të kategorizuara si të brendshme për qëllime të ruajtjes së interesit publik siç janë të definuara në Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve;

  c. Revidimi i të gjitha informacioneve të klasifikuara në institucionet shtetërore, bashkëngjitur me publikimin e atë se cilat lëndë nuk kanë të bëjnë me sigurinë e shtetit po janë të klasifikuara si të tilla që të fshihet shpenzimi i buxhetit:

Afatmesëm

- Përsëri të vendoset dhe të bëhet obligim më efikas juridik për lidhje të ndërsjellë të DHP dhe KSHPK për kontroll të kryqëzuar të listave anketuese;
- Të përforcohen masat ligjore për 70% tatim të pronës jolegjitime dhe të nxitet aplikim adekuat të Kodit penal në pjesën e fshehjes së prejardhjes së pronës së përvetësuar në mënyrë joadekuate (359a);
- Të përforcohet aplikimi i konfiskimit final në fazën e hershme të prodcedurës penale për raste që kanë të bëjnë me korrupsionin;
- Të vendoset dhe rritet kapaciteti i Qendrave hetuese të PPKOK;
- Të sigurohen resurse të mjaftueshme (njerëzore – ekspertë për të dhëna) që të mundësohet vëzhgimi i thelluar i konfliktit të interesave dhe korrupsionit për të gjithë personat e emëruar dhe të zgjedhur, si dhe për administratën, me kontrolle të automatizuara të kryqëzuara me të dhëna nga furnizimet publike dhe punësimi;
- Publikimi i informacioneve për pronësi të emrit të partive politike;
- Përforcimi i kompetencave të ESHR për vëzhgimin e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe prejardhja e parave të donuara për partitë politike;
- Lidhje të Regjistrit të pronës të të ardhurave dhe interesave të personave të zgjedhur dhe të emëruar me DHP.

INSTITUCIONE KYÇE DHE ROLI I TYRE I MUNDSHËM

- MPB, PPKOK, PSP, KSHPK, ESHR.
- KSHPK ka rol që të inkurajojë denoncimet e korrupsionit si dhe dorëzimin e rasteve drejtë prokurorive publike me detyrë zyrtare.

- ➢ Me ndryshim të përgjegjësve në Prokurorinë publike dhe në PPKOK të nxitet rritje të besueshmërisë publike në institucionet bashkë me kapacitete të zmadhuara njerëzore dhe teknike të PPKOK.
- ➢ ESHR ka kapacitet që në koordinim me DHP dhe KSHPK e re dhe në pajtim me këshillët e organizatave qytetare, të përpilojë raport përfundimtar si bazë për ligjin për partitë politike i bazuar në financim publik.
- ➢ MPB është një nga institucionet kryesore se si duhet të kryhen vlerësime të rreziqeve nga korrupsioni dhe nevojitet që të zhvillohen plane për integritet. Ky instrument i përfshin edhe MPPS, MBPEU dhe të gjitha institucione të tjera me inspektorate. Si prioritet kjo duhet t'i përfshijë inspektorati i tregut dhe DHP.
- ➢ KSHPK, PP, MPB dhe Avokati i Popullit është e nevojshme që të vendosin aplikim efektiv të rolit ligjor për denoncim të jashtëm të korrupsionit përmes Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve.

ZGJEDHJET DHE SISTEMI ZGJEDHOR

HYRJE

Njëra nga shkaqet e krizës aktuale politike janë dyshimet e bazuara n; parregullësi zgjedhore të ekzekutuara nga partitë në pushtet. Disa faktorë janë kyçe për organizimin e zgjedhjeve të drejta dhe të lira, ose kredibile: vazhdimi i reformës së Komisionit shtetëror zgjedhor, pastrimin e Listës zgjedhore dhe sigurim të ndarjes së shtetit nga partitë politike[10].

Përveç krizës politike, ekzistojnë më tepër dobësi afatgjate të zgjedhjeve dhe sistemit zgjedhor të cilat gjithashtu duhet të tejkalohen. Në të vërtetë, mënyra në të cilën deputetët zgjedhen (përmes sistemit zgjedhor proporcional me lista të mbyllura) ka më tepër dobësi. Deputetët nuk ndihen përgjegjës para qytetarëve, por para udhëheqësisë partiake, kurse në listat kandiduese vendosen kuadro të cilët janë bindës ndaj udhëheqësisë, në vend të personave kompetent. E gjithë kjo rezulton me dobësim të marrëdhënies mes deputetëve dhe qytetarëve, gjë që e dëmton thelbin e demokracisë përfaqësuese- deputetët zgjidhen që t'i përfaqësojnë interesat e qytetarëve.

Votimi në diasporë është gjithashtu i kontestueshëm, nga aspekti i së drejtës për qasje të barabartë në vendvotim, si dhe nga aspekti i kohëzgjatjes së qëndrimit në diasporë si kusht për votim në diasporë.

Partitë politike e shfrytëzojnë kohën mes shpalljes së zgjedhjeve dhe konfirmimit të listave zgjedhore për promovim të kandidatëve dhe programeve të tyre. Në Kodin zgjedhor, fushata zgjedhore është e definuar si prezantim të kandidatëve të konfirmuar, kështuqë kjo praktikë nuk është në kundërshtim me predispozitat ligjore. Megjithatë, edhe pse në mënyrë formale-ligjore nuk bëhet fjalë për fillim të parakohshëm të fushatës zgjedhore, këto ngjarje në fakt paraqesin promovim të kandidatëve dhe programeve të tyre të ardhshme, pa marrë parasysh që ato nuk janë konfirmuar akoma nga KSHZ-ja.

PARIMET E PËRGJITHSHME

1. Vazhdimi i reformës së KSHZ-së

Me qëllim që KSHZ-ja ta sigurojë ligjshmërinë e procesit zgjedhor, reformimi i KSHZ-së duhet të vazhdojë, duke i patur parasysh këto qëllime:

- ➢ të sigurohet pavarësi e proceseve përmes ndarjes së vendimmarrjes nga implementimi;

[10] Roli i mediave është e përfshirë në kapitull të veçantë.

- KSHZ t'i praktikojë të gjitha kompentencat që i takojnë dhe që rezultojnë dhe janë në përputhje nga Kodi zgjedhor dhe ligjet tjera;
- të përforcohen kapacitetet e KSHZ-së (vendimmarrës/anëtarë të komisionit dhe zbatues/shërbimi profesional).

2. Pastrimi i Listës zgjedhore

Me qëllim që të përforcohet besimi në zgjedhje, pavarësisht se cili metod do të zgjidhet për pastrim/krijim të Listës zgjedhore, procesi i pastrimit të tij duhet të bazohet në këto kritere:

- të jetë transparent dhe gjithpërfshirës;
- të jetë i planifikuar dhe organizuar mirë;
- të zbatohet në afat të duhur kohor;
- të mbështetet dhe koordinohet në mënyrë efikase nga institucionet kompetente;
- të përfundojë para shpalljes së zgjedhjeve.

3. Sigurim i ndarjes së shtetit nga partitë politike

- ballafaqim me lidhjen e shtetit dhe partive politike si në nivel nacional, ashtu edhe në nivel lokal.

4. Tejkalim i dobësive të procesit zgjedhor dhe sistemit zgjedhor

- rishikim i variacionit të listave të mbyllura, rishikim i votimit në diasporë dhe sigurimit të kushteve të drejta për fushatë zgjedhore për të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje.

INSTRUMENTE

1. Vazhdim i reformës në KSHZ

- pavarësia e KSHZ-së duhet të sigurohet në këtë mënyrë:
  - ridizajnim të procesit të profesionalizimit të administratës zgjedhore. Ridizajnimi duhet të fillojë nga organi më i lartë (KSHZ) dhe pas disa proceseve zgjedhore duhet t'i përfshijë organet më të ulëta (KKZ dhe KZ). Për proceset e ardhshme zgjedhore, KZZ dhe KZ duhet të përbëhet nga një anëtar i administratës dhe nga dy anëtarë të partive në pushtet dhe partive opozitare;
  - zbatim i revizionit të punës së përbërjes aktuale të KSHZ-së me mundësi për shkarkimin e disa prej anëtarëve aktual;
  - me qëllim që të sigurohet nivel i nevojshëm për profesionalizëm, Kuvendi duhet të zgjedhë sekretar gjeneral (drejtor ekzekutiv) të shërbimit profesional me 2/3 shumicë;
  - transferim të të gjitha kompetencave në drejtim të implementimit, duke e përfshirë edhe krijimin e Listës zgjedhore, të shërbimit profesional. Aktivitetet dhe dokumentet të cilat rezultojnë nga

kompetencat e shërbimit profesional nuk duhet të jenë subjekt i miratimit/votimit nga ana e anëtarëve të KSHZ-së;

- Shërbimi profesional i KSHZ-së, duhet të përgatisë plan të hollësishëm për punën e tij, duhet të jetë i aksesshëm publikisht dhe duhet të përbëhet nga këto elemente:
  - Përforcim të resurseve institucionale, teknike dhe njerëzore, si në selinë qendrore, ashtu edhe në njësitë dhe zyrat rajonale;
  - Vlerësim të Rregullores së përkohshme dhe miratimin e Rregullores së re të KSHZ-së dhe rregulloreve të tjera;
  - Sigurim të mbështetjes dhe rekomandimeve për procesin e harmonizimit të të gjitha ligjeve lidhur me zgjedhjet;
  - Komunikim dhe bashkëpunim me institucionet kompetente - në këtë fazë do të jetë e nevojshme mbështetje teknike ndërkombëtare.

- Për zgjedhjet e ardhshme, Qeveria duhet të sigurojë mjete për funkcionim të KSHZ-së në përputhje me planin e propozuar nga KSHZ.
- Lloje të ndryshme të mbështetjes teknike duhet t'u sigurohen anëtarëve të KSHZ-së dhe shërbimit profesional.

2. Pastrimi i Listës zgjedhore

- Shërbimi profesional i KSHZ-së duhet të jetë kompetent për krijim (jo për udhëheqje dhe azhurnim) të Listës zgjedhore. Shërbimi profesional duhet të ketë kompetencë që mos t'i shënojë në Listën zgjedhore votuesit për të cilët do të vërtetojë se kanë fituar të drejtën për votim me shkelje të procedurave ose ato votues të cilët nuk kanë më të drejtë të jenë në Listën zgjedhore. Duhet të mundësohet mjet juridik, si për institucionet, ashtu edhe për qytetarët;
- Përgatitje e metodologjisë së re për krijimin e Listës zgjedhore e cila do t'i zëvendësojë dy metodologjitë ekzistuese dhe e cila do t'i përfshijë dispozita të qarta dhe procedura për kryerje të kontrolleve të kryqëzuara dhe administrative të bazave të të dhënave të dorëzuara nga institucionet kompetente;
- Këshillet komunale zgjedhore (KKZ) duhet të përfshihen në procesin e pastrimit dhe krijimit të Listës zgjedhore;
- Përbërja e re e KSHZ-së duhet të bëjë vlerësim dhe të përgatisë raport për kontrollin administrativ dhe në terren të Listës zgjedhore e realizuar nga përbërja aktuale;
- Nëse nuk ka reforma në procesin e udhëheqjes së Listës zgjedhore për sigurim të zgjedhjeve kredibie, atëherë duhet të shqyrtohet mundësia për futje të regjistrimit aktiv të votuesve. Kjo do të mundësojë kontrollë të procesit të regjistrimit të vetë qytetarëve, gjë që do të kontribojë në kthimin e besimit në Listën zgjedhore.

- Përforcim i kapaciteteve të institucioneve kompetente për azhurnim të Listës zgjedhore:
  - sektori ligjor dhe sektorët për teknologji informatike dhe Lista zgjedhore;
  - emërtim i një eksperti/këshilltari të ministrit për punë të brendshme i cili do të jetë përgjegjës për koordinim të procesit të këtij institucioni dhe njëkohësisht do t'i koordinojë dhe do t'i komunikojë institucionet tjera – në këtë fazë është e nevojshme mbështetja teknike ndërkombëtare;
- Zgjidhja e problemit me emrat e rrugëve dhe numrat e shtëpive:
  - Vlerësim i gjendjes së regjistrit momental të rrugëve dhe numrave të shtëpive të cilën e udhëheq Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, krahasim i të dhënave të tij me të dhënat e Agjencionit Kadastral dhe institucioneve të tjera dhe, nëse është e nevojshme krijimin e regjistrit të ri;
  - Krahasimi historik i të dhënave administrative duhet të merret si pikënisje, e kjo do të kontribojë në pastrimin e Listës zgjedhore;
  - Rregullim i kushteve për ndryshim të emrave të rrugëve, e shoqëruar me aktivitete përkatëse që do t'i mundësojnë qytetarëve procedurë efektive dhe pa pagesë për t'i ndryshuar të dhënat e tyre.

- Përgatitje e protokollit për komunikim efikas dhe efektiv përmes institucioneve përgjegjëse për azhurnim të Listës zgjedhore dhe aspekteve të tjera, siç janë emrat e rrugëve. Protokolli duhet të jetë në dispozicion të publikut.

3. Sigurim të ndarjes së shtetit nga partitë politike

- Parandalim të rasteve të mundshme të frikësimit të votuesve nga ana e zyrtarëve administrativ;
- Ndjekje të rekomandimeve nga Rekomandimet e përbashkëta për parandalim dhe reagim të keqpërdorimit të resurseve administrative gjatë procesit zgjedhor ana ana e Komisionit të Venedikut dhe OSBE/ODIHR;
- Ministria për vetëqeverisje lokale, së bashku me BNJVL dhe organizata të tjera relevante duhet të pregatisë plan dhe aktivitete për atë se si mund të sigurohet ndarje e shtetit nga partitë politike në nivel lokal. Duhet të parashikohen masa në raste kur përveç zyrtarin/politikanin, mosrespektimi i këtij parimi provokon pasoja edhe për partinë politike;
- Hulumtim i të gjitha rasteve të dyshimta të presioneve ndaj të punësuarve në administratë, ngritje të padisë dhe zbatim të proceseve gjyqësore.

4. Tejkalim i dobësive në procesin zgjedhor dhe sistemin zgjedhor

- Të shqyrtohet mundësia për futje të modelit të listave të hapura, ku përveç për subjektin politik, mund të votohet edhe për kandidat të listës
- Të rishikohet sistemi për votim në diasporë, duke e patur parasysh mundësinë të pabarabartë për realizim të së drejtës për votim. Kjo duhet të bëhet përmes një debate të gjerë për të gjitha aspektet e tij – numri dhe vendi i banimit të shtetasve të RM-së të cilët jetojnë në diasporë, sistemi zgjedhor, numri i njësive zgjedhore, numri i deputetëve, barazia e votes, mënyra e votimit, etj. me qëllim që të gjenden zgjidhje më demokratike, më efektive dhe më pak të kushtueshme, që do të jenë në interes të të gjithë shtetasve të RM-së. Nëse kjo nuk ndodh para zgjedhjeve të ardhshme, atëherë votimi në diasporë duhet të suspendohet për ato zgjedhje.
- Të vendoset se cilat aktivitete janë të lejuara gjatë periudhës ndërmjet shpalljes së zgjedhjeve dhe konfirmimit të listave kandiduese. Opsionet të cilat janë në dispozicion dhe me të cilat do të eliminohet mundësia për fillim të parakohshëm të fushatës zgjedhore janë që fushata të fillon nga vetë shpallja e zgjedhjeve ose aspak të mos rregullohet. Vendimet e këtilla mund të gjinden edhe në më tepër shtete të Evropës, si dhe në SHBA.

INSTITUCIONE KYÇE DHE ROLI I TYRE I MUNDSHËM

Vazhdim i reformës së KSHZ-së
Kuvendi i RM-së

Pastrim i Listës zgjedhore
Kuvendi i RM-së, Ministria për punë të brendshme, KSHZ, Enti shtetëror për statistikë, Ministria për drejtësi, Drejtoria për evidencë të librave amë, Regjistri qendror i RM-së, Agjencioni kadastral, njësi të vetëqeverisjes lokale.

Sigurim i ndarjes së shtetit nga partitë politike
Qeveria e RM-së dhe të gjitha organet e drejtorisë shtetërore, Prokuroria publike dhe gjykatat (hulumtim i rasteve të presionit ndaj të punësuarve në administratë, ngritja e padive dhe zbatim i proceseve gjyqësore), Ministria për vetëqeverisje lokale, BNJVL dhe organizata të tjera qytetare relevante.

Tejkalim i dobësive në procesin zgjedhor dhe sistemin zgjedhor
Kuvendi i RM-së

MEDIA

HYRJE

Mangësitë sistematike në sektorin e mediave, në mënyrë serioze e pengojnë zhvillimin demokratik të shtetit. Për këtë shkak, si hyrje për ndryshime afatgjate sistematike duhet të bëhen ndërhyrje kyçe emergjente dhe tu mundësohet kohë e mjaftueshme që të njejtat të kenë ndikim në sferën publike. Procesi për reforma emergjente duhet të fillojë menjëherë pas krijimit të qeverisë kalimtare dhe duhet të përfundojë në afat prej 2-3 muaj pa asnjë prolongim. Pas përfundimit të këtij procesi duhet të mundësohet kohë e mjaftueshme që reformat të futen në fuqi dhe ta relaksojnë sferën publike. Ndërhyrjet kyçe duhet të fokusohen në 6 probleme kryesore:

- Mungesa e pavarësisë të trupit rregullator nga partia në pushtet, nga industria e medias dhe qendrave të tjera të fuqisë;
- Lidhja klienteliste mes mediave kryesore komerciale (pronarët, menaxherët dhe redaktorët) dhe funksionerët e lartë qeveritar/partiak;
- Mungesa e autonomisë dhe pavarësisë institucionale të Shërbimit të transmetimit publik;
- Mungesa e transparencës së institucioneve publike;
- Përhapja e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit përmes programeve të transmetuesve publik;
- Rrezikim i sigurisë dhe mungesa e sigurisë së gazetarëve.

Në Maqedoni veçmë është aktiv grupi i punës i cili është i angazhuar për zgjidhje të këtyre problemeve – i përbërë nga përfaqësues të organizatave qytetare nga Koalicioni i sektorit të medias, i cili i përfshin: Shoqatën e gazetarëve të Maqedonisë, Sindikati i pavarur i gazetarëve dhe punëtorëve medial, Instituti për studime të komunikimit, Instituti maqedonas për media dhe Këshilli për etikë në media. Grupi i punës i përfshin gjithashtu edhe organizatat e medias jashtë këtij koalicioni, gjegjësisht: OJQ Info-qendra dhe Qendra për zhvillim të mediave, si dhe grupe të ekspertëve të pavarur. Grupi i ardhshëm tematik i punës, përveç këtyre organizatave, do t'i përfshijë edhe përfaqësues të posa emëruar të Ministrisë për shoqëri informatike dhe administratë, komisionet përkatëse parlamentare, si dhe përfaqësues të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

INSTRUMENTE URGJENTE

1. Ndryshime dhe plotësime në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele

- Ndryshim ligjor për ndalesë të çdo „publiciteti shtetëror" në mediat elektronike komerciale dhe definim të qartë të terminit „Fushatë publike". Përveç kësaj, duhet në mënyrë të qartë të definohen kushtet mbi të cilat fushatat publike mund të emitohen në shërbimin e transmetimit publik;
- Ndyshim ligjor për ndalesë të çdo reklame partike/politike të paguar në media private, edhe gjatë periudhës së procesit zgjedhor edhe jashtë tij;
- Ndryshim ligjor për ndryshimin e strukturës për vendimmarrje dhe mënyrës së nominimit dhe zgjedhjes së anëtarëve të trupit rregullues (Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele), me qëllim të depolitizimit të saj;
- Ndryshim ligjor për ndryshim të përbërjes dhe kapacitetit të Këshillit të programit të RTM-së me qëllim të depolitizimit të këtij trupi dhe përforcimit të marrëdhënies së SHTP-së dhe shoqërisë civile;
- Ndryshim ligjor të kornizës për financim të SHTP-së, me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëri afatgjate, pavarësi editoriale dhe autonomi institucionale;
- Ndryshime ligjore lidhur me emërtimin e redaktorëve përgjegjës të RTM-së – Këshilli i programit të RTM-së duhet të jetë i autorizuar për emërtim pas një procedure të realizuar të konkursit publik;
- Ndryshime ligjore për ndalim të dispozitave lidhur me „kuotën kulturore" për produkcionin vendor dokumentar dhe artistik për mediat televizive nacionale, dispozitat që lidhen me fondet e Buxhetit të destinuara për produkcion të tillë, si dhe gjobat për shkeljen e këtyre dispozitave;
- Ndryshime ligjore për reduktim të shkeljeve të caktuara të ligjit, si dhe për zvogëlim të kostos vjetore për transmetuesit për rreth 50%.
- Ndryshime ligjore për futje të dispozitave për sanksionimin e gjuhës së urrejtjes apo nxitjen e dhunës në programe audiovizuele (neni 48 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele) në procedura penale; trupat rregullatore në të gjitha shtetet evropiane mund të ngrisin procedurë për shkelje dhe të shqiptojnë gjoba për emitim të gjuhës së urrejtjes. Dispozitat e këtilla janë në përputhje me nenin 10 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

2. Ndryshime në përbërjen e Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatike audio, si dhe në përbërjen e Këshillit të programit të RTM-së

- Menjëherë pas miratimit të ndryshimeve në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, është e nevojshme të nominohen dhe të zgjidhen anëtarët e rinjë të Këshillit të Agjencisë dhe të Këshillit të programit të RTM-së me procedurë urgjente (gjithashtu, duhet të krijohen edhe afate

më të shkurtëra me dispozitat kalimtare të Ligjit). Këshilli i ri i programit të RTM-së duhet, në përputhje me kompetencat e tij ligjor, t'i shqyrtojë funksionet e programit të RTM-së në lidhje me interesat e qytetarëve dhe të kërkojë nga menaxhmeti dhe nga stafi editorial të jenë në përputhje me parimet e interesit publik.

3. Dhunë dhe frikësim i gazetarëve

- Institucionet publike (Qeveria, Ministria për punë të brendshme, gjykatat, etj.) duhet të ndërmarrin masa të nevojshme për mbrojtje të gazetarëve dhe menjëherë t'i hulumtojnë të gjitha rastet e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, si dhe parashtresat për të cilat nuk ka reagim të duhur. Funkcionerët qeveritar, zyrtarët administrativ dhe përfaqësuesit gjyqësor duhet të japin deklarata të qarta me të cilat do t'a afirmojnë sigurinë e gazetarëve dhe do t'i dënojnë sulmet ndaj tyre.

4. Transparenca e institucioneve publike

- Qeveria, ministritë përkatëse, Kuvendi, gjykatat dhe institucionet të tjera, përfshirë edhe ASHMAA dhe RTM, duhet menjëherë të sigurojë qasje të drejtë dhe të barabartë në informacione të karakterit publik për të gjitha mediat. Ata duhet të punojnë në mënyrë transparente, të kenë marrëdhënie të hapura, jodiskriminuese dhe të drejta me mediat dhe nuk duhet t'i privilegjojnë mediat të cilat janë të lidhura ngushtë me partitë politike.

INSTITUCIONET KYÇE DHE ROLI I MUNDSHËM I TYRE

- **Ministria për shoqëri informatike dhe administratë** e cila duhet të përgatisë propozim-ndryshimet e ligjit.
- **Kuvendi** duhet t'i miratojë ndryshimet e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele në procedurë urgjente. Gjithashtu, duhet t'i zgjedhë anëtarët e nominuar të Këshillit të ri të ASHMAA dhe Këshillit të programit të RTM-së. Për këtë qëllim, komisionet parlamentare do të organizojnë diskutime publike me përfshirje të shoqërisë civile.
- **Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele:** bashkëpunimi i Shërbimit profesional të trupit rregullator ka rëndësi të madhe.
- **Radio televizioni maqedonas:** Përfaqësues të SHTP-së, veçanërisht përfaqësuesit e sektorit të programit, duhet të përfshihen në proces që të sigurohet që nuk ka rezistencë apo sabotim të ndryshimeve pozitive.

ADMINISTRATA PUBLIKE

HYRJE

Reformat në Maqedoni të cilat zgjasin më tepër se dy dekada nuk na kanë çuar deri në administratë të bazuar në parimin e vlerave dhe meritave dhe të drejtuar drejt shërbimeve për qytetarët. Përkundrazi, administrata publike ka qenë fuqishëm e politizuar dhe e përdorur si një nga shtyllat kryesore të klientelizmit partiak. Procesi i erozionit të institucioneve i rrezikoi parimet e e barazisë dhe mosdiskriminimit. Përveç kësaj, ndryshimet e shpeshta të kornizës ligjore, së bashku me zbatiminin selektiv të saj dhe mungesës së transparencës, krijuan pasiguri brenda në administratë, por edhe në aspekt të sigurimit të shërbimeve të qytetarëve. Procesi dhjetëvjeçar i punësimit dhe avancimit joobjektiv kontribuan në robërimin e institucioneve. .

Masat e propozuara kanë për qëllim përforcimin e sistemit të punësimit dhe avancimit në bazë të vlerave dhe meritave, gjë që do të nxisë profesionalizëm dhe kompetencë në administratën publike. Qëllimi përfundimtar është që të kthehet integriteti i institucioneve dhe besimi në to, si dhe të arrihet administratë e dimenzionuar proporcionalisht, profesionale, politikisht e pavarur dhe efektive.

Duke e patur parasysh praktikën e rrënjosur për përzierje të shtetit dhe partisë, qeveria kalimtare (eksperte) duhet në mënyrë vendimtare t'i ndërpresë praktikat klienteliste dhe të sigurojë ndarje efektive të shtetit nga partia.

PARIME TË PËRGJITHSHME

- Sigurim i ndarjes së shtetit nga partia;
- Garancë që resurset publike nuk do të shfrytëzohen për aktivitete/zgjedhje partiake;
- Sigurim i bashkëpunimit mes PPS dhe të gjithë trupave qeveritar;
- Prioritizim i qasjes „zero tolerancë për korrupsion";
- Të sigurohet qasje e plotë në informatat me karakter publik dhe rritje të transparencës së institucioneve;
- Shkarkimi dhe emërimi i funkcionerëve të rinj në të gjitha pozicionet me emërim në organet e drejtorisë shtetërore (ministri, organe në kuadër të ministrive, komisione, fonde, agjencione, byro, etj) të cilët janë kompetent për respektim të parimeve të parashtruara në këtë dokument dhe sigurimi i zgjedhjeve të lira dhe të drejta;
- Kufizime në punësim në sektorin publik;
- Të sigurohet barazi dhe siguri juridike në procedurat administrative; gjobat duhet të bazohen në proporcionalitet;
- Nuk duhet të ketë shkarkime arbitrare në administratën publike;

- Sigurim dhe përforcim të pavarësisë së administratës (veçanërisht gjatë sjelljes së vendimeve për të drejta qytetare – procedura administrative);
- Të sigurohet efikasitet të institucioneve në administratën publike;
- Të nxitet përfshirja dhe debati brenda në administratë dhe me shoqërinë civile;

INSTRUMENTE

- Qeveria të publikojë deklaratë që aktivitetet joligjore partiake në institucionet publike nuk do të tolerohen;
    - Deklarata duhet të shpërndahet gjerësisht nëpër institucione, organe
      dhe organizata të sektorit publik, si dhe përmes mediumeve;
- Qeveria të miratojë udhëzim për parandalim të mekanizmave për keqpërdorim të shtetit për qëllime partiake;
    - Udhëzimi duhet të përmbajë instrukcione të hollësishme për zbatim të predispozitave ligjore përkatëse të ligjeve dhe rregulloreve nënligjore përkatëse (Ligji për punësim në sektorin publik, Ligji për zyrtarë administrative, Kodi zgjedhor dhe rregullore të tjera). Dokumenti duhet të shpërndahet në tërë administratën publike dhe të publikohet në media;
- Emërtim i: sekretarëve general/sekretarëve shtetëror në ministri; borde drejtuese në institucione; drejtorë të institucioneve/agjencioneve dhe vendeve tjera prioritare lidhur me qëllimet kryesore të Dokumentit, në bazë të parimit të vlerave dhe meritave dhe kompetencave;
- Organet e drejtorisë shtetërore në kohë të përgjigjen në kërkesat e PPS-së dhe të monitorohet respektimi i këtyre kërkesave;
- Të formohet grupi i punës - antikorrupsion në nivel qeveritar:
    - Grupi duhet të ketë fushëveprim të qartë për përforcim të zbatimit të Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe praktikave antikorruptuese, para së gjithash në Qeveri, në mënyrë që Qeveria të jetë shembull për "zero tolerancë" për korrupsion;
- Propozohet që anëtarët e qeverisë kalimtare eksperte të paguhen në shumë prej rrogës mesatare të Republikës së Maqedonisë (opinionet për këtë janë të ndryshme);
- Embargo të punësimeve të reja dhe kufizim të shkarkimeve në sektorin publik deri në mbajtjen e zgjedhjeve;
- Të ndalohen marrëveshje për punësim të përkohshëm në administratën publike përmes agjencioneve për punësime të përkohshme;
- Në mënyrë strikte të zbatohen predispozitat e Ligjit të ri për të punësuarit në sektorin publik në aspekt të përfaqësimit të barabartë dhe të përforcohen gjobat për mosrespektim të zbatimit; në mënyrë strikte të zbatohet Metodologjija për punësim në sektorin publik, përfshirë edhe ndarjen e vendeve të punës të personave veçmë të punësuar në administratë publike sipas parimit për përfaqësim të barabartë në organet dhe trupat e administratës publike;

- Të sigurohet funksionim i pavarur i Agjencionit për administratë, përfshirë edhe emërtimin drejtor dhe zëvendës drejtor në bazë të vlerave dhe meritave, duke i respektuar kriteret e fuqishme për profesionalizëm dhe integritet;
- Të krijohen parime/standarde për bartësit e funksioneve publike;
- Të futen dënime më të ashpra, veçanërisht zyrtarëve administrativ në lidhje me ndalesën për aktivitete partiake, duke i përfshirë këtu edhe aktivitetet lidhur me zgjedhje;
- Të sigurohet drejtësi administrative dhe procedurale e të gjithë të punësuarve, pa diskriminim;
- Të implementohen politika (përmes „drejtësi e butë ", si psh. udhëzime) të cilat do të sigurojnë që gjobat administrative (shkeljet) të jenë opsioni i fundit; fokusi duhet të jetë në parandalim dhe jo në represion;

Afatshkurtër

- Të rritet volumi i të dhënave të hapura të publikuara nga Qeveria;
- Të sigurohen të dhëna gjithëpërfshirëse për punësimet ekzistuese afatgjate në bazë të marrëveshjes për punësim të përkohshëm dhe të zhvillohen opcionet për zgjidhje të punësimeve të këtilla;
- Të qartësohen rolet dhe përgjegjësitë e zyrtarëve në kabinetet dhe këshilltarët politik në ministri, përfshirë edhe numrin e tyre, rroga, shpërblimet, etj;
- Të publikohet regjistër i azhurnuar rregullisht i të punësuarve në sektor publik, me çka të dhënat do të mbahen dhe azhurnohen në nivel të drejtorisë dhe në nivel të sektorit publik;
- Të publikohet një përmbledhje e vendeve të plotësuara të punës në administratën publike sipas kategorisë, vitit të punësimit dhe përvojës së punës, si dhe përmbledhje të masave disiplinore sipas kategorive të sipërpërmendura, që të mundësohet vlerësim i praktikave për punësim.

Afatmesëm

- Të sigurohet mandat për Komisionin për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik që të inicojë procedure për shkelje kundër mbajtësve të informacioneve të cilat nuk i kanë dorëzuar informacionet e kërkuara;
- Përmbledhje të të gjitha informacioneve të klasifikuara në kuadër të organeve shtetërore, e shoqëruar me të dhëna që nuk kanë të bëjnë me sigurimin e shtetit, por janë "të klasifikuara si të tilla" nga ana e mbajtësve të informacioneve me qëllim që të mbulohet shpenzimi i buxhetit shtetëror;

- Rregullim të marrëveshjeve për punësim të përkohshëm në administrate në ligjit të cilat e rregullojnë administratën, në bazë të parimit për vlera dhe merita;
- Avancim të konceptit të interesit publik, përfshirë edhe rolin e administrates në mbrojtjen e interesit publik;
- Kthim të formatit të komisioneve disiplinore në tri anëtarë dhe caktim të përgjegjësisë më të madhe të njësive të burimeve njerëzore në procedure disiplinore;
- Ndryshime në metodologjinë e re për vlerësim të zyrtarëve administrative, sipas vlerave dhe meritave;
- Ndarje të autorizimeve zyrtarëve administrative në zbatimin e procedurave administrative përmes përshkrimit të vendit të punës;
- Rritje të delegimit të përgjegjësive zyrtarëve administrativ;
- Të mundësohet debat inkluziv (e bazuar në vlerësim të thellë të ndikimit të rregullores) për Strategjinë e re për reformë të administratës[11]
    - Të shqyrtohet mundësia për reformim ose lënie të sistemit të vendeve të hapura të punës, në mënyrë që kjo praktikë do të ishte përjashtim, e jo parim i përgjithshëm për punësim të zyrtarëve administrativ, si dhe krijimi i një sistemi të karrierës (opinionet për këtë çështje janë të ndryshme); të diskutohen mundësitë për sekretarë të përhershëm ose sekretarë me mandate të mbivendosura dhe krijimi i një grupe të zyrtarëve të lartë shtetërorë e cila do të jetë plotësisht e profesionalizuar, kurse mandatet e tyre do të jenë të ndara nga mandatet e Qeverisë;
    - Të shqyrtohet mundësia për përforcim dhe zgjerim të rolit të Agjencionit për administratë.

INSTITUCIONET KYÇE DHE ROLI I MUNDSHËM I TYRE

- Qeveria e RM-së ka rol kyç në: pengimin e ndikimit partiak në administratën publike, sigurimin e mbështetjes për Prokurorinë publike speciale, sigurimin e resurseve dhe koordinimin e kontributit të organeve të administratës publike në procesin zgjedhor, sigurimi i kushteve për zgjedhje kredibile, emërtimi i funksionerëve qeveritar;
- Ministria për shoqëri informatike dhe administratë: të gjitha përgjegjësitë lidhur me administratën publike (Inspektorati shtetëror administrativ është organ në përbërje të kësaj ministrie);
- Agjencioni për administratë: përgjegjëse për procedurat për punësim, instancë e dytë në procedurën disiplinore;
- Ministria e financave: ndarje e mjeteve buxhetore për shërbime publike dhe për të punësuarit në sektor publik; pajtueshmëri e detyrueshme për të gjitha punësimet në sektor publik;

[11] Përpunimi i Strategjisë së re për reformë të administratës publike ka filuar.

- Sekretariati për implementim të Marrëveshjes së Ohrit: e zbaton Strategjinë për përfaqësim të barabartë;
- Inspektoratët, komisionet për gjoba: aktorët kyç në shqiptimin e gjobave;
- Kuvendi i RM-së: funkcion mbikëqyrës: emërtim i trupave të pavarur mbikëqyrës dhe rregullues (p.sh. emërtim i Drejtorit dhe zëvendës drejtorit të Agjencionit për administratë) ; mund të miratojë dokumente (rezoluta/deklarata/rekomandime) me të cilat do të tregojë përkushtim në ngritjen e parimeve dhe standardeve për administratën publike;
- Ministria për drejtësi: përgjegjëse për rregullat në fushën e qasjes së lirë deri te informacionet me karakter publik;
- Komisioni për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik – vendimmarrje pas ankesave për kërkesat; përgjegjësi në lidhje me zbatimin e Ligjit;
- Gjykatat e rregullta – përgjegjëse për kontestet në punë të të punësuarve (përfshirë edhe sektorin publik);
- Gjykatat administrative – përgjegjëse për kontestet administrative.

KONTROLLI MBI POLICINË DHE AGJENCITË PËR SIGURI DHE (KUNDËR)ZBULIM

HYRJE

Puna e Ministrisë për punë të brendshme është subjekt i kontrollit të brendshëm nga ana e Sektorit për kontrollë të brendshme dhe standarde profesionale në kuadër të MPB-së dhe kontrollë e jashtme nga Komisioni për mbrojtje dhe sigurim dhe Avokati i Popullit. dhe të jashtëm . Megjithatë, mekanizmat e këtilla nuk i arritën rezultatet e pritura, kurse dëshmia më e madhe për këtë janë bisedat e përgjuara në mënyrë joligjore të cilat u publikuan gjatë vitit 2015. Në vitin 2012, partitë opozitare në Kuvend dorëzuan propozim-ligj për ombdusman policor, por që u refuzua nga shumica parlamentare. Në prill të vitit 2014, MPB-ja deklaroi se do të krijojë mekanizëm të pavarur për kontrollë të jashtme. Në vitin 2016, me mbështjetje të Këshillit të Evropës dhe MPB-së, u formua grupi i punës me ekspertë me qëllim që të gjendet zgjidhje adekuate për Maqedoninë.

PARIME TË PËRGJITHSHME

- parimi kryesor është që të sigurohet bilanc mes mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe sigurisë publike, kontrollë civile kredibile, efektive dhe të jashtme të fuqisë policore dhe shërbimeve të fshehta;
- përforcim të kontrollit parlamentar mbi policinë dhe agjencitë për zbulim (shih kapitullin Kuvendi);
- futjen e policëve rajonal;
- sigurim të integritetot dhe profesionalizmit të agjencioneve për sigurim dhe zbulim.

INSTRUMENTE

Urgjente

- Puna e grupit të punës e përbërë nga ekspertë e mbështetur na Këshilli Evropian dhe MPB-ja duhet të mbështetet dhe përshpejtohet;
- Mekanizmi i ardhshëm i pavarur për kontrollë të pavarur mbi policinë duhet të përfshijë anëtarë të organizatave qytetare, universiteteve, prokurorëve publik dhe oficerëve të pensionuar policor – në mënyrë të barabartë, me përgjegjësi dhe detyra të barabarta. Duhet të futen kriteriume të ashpra për anëtarësim;
- Futjen e kriteriumeve të ashpra për profesionistët në agjencionet për sigurim dhe respektimi i tyre.

INSTITUCIONE KYÇE DHE ROLI I MUNDSHËM I TYRE

Ministria për punë të brendshme, Kuvendi i RM-së, Kryetari i Republikës së Maqedonisë, Drejtoria për sigurim dhe kundërzbulim, Agjencioni për zbulim (në juridiksion të Kryetarit të RM-së).

KUVENDI

HYRJE

Në vitet e fundit Kuvendi u bë më i varur nga pushteti qendror. Qeveria dhe ministritë janë propozuesit më të mëdhenj të ligjeve, ndërsa Kuvendi funksionon vetëm si konstatues të propozim-ligjeve, me ç'rast e minimizon rolin e tij ligjvënës. Kjo kontribuoi në zvogëlimin e cilësisë së legjislacionit, pasigurisë juridike, shkeljes së parimit të ndarjes së pushtetit, uljes së rëndësisë të rolit kontrollues të Kuvendit dhe përgjegjësi dhe transparencë të zvogëluar të dy degëve të pushtetit publik.

PARIME TË PËRGJITHSHME

Në periudhën e ardhshme roli i Kuvendit duhet medoemos të përforcohet në disa aspekte kyçe, ndërsa zbatimi i plotë i Ligjit për Kuvend dhe Rregullores së Kuvendit patjetër duhet të mundësohet. Kuvendi duhet medoemos të jetë më transparent ndaj publikut politik. Patjetër duhet t'i jepet prioritet funksionimit dhe përforcimit të mekanizmave për kontroll parlamentar mbi Qeverinë me qëllim që të arrihet nivel më i lartë i përgjegjësisë nga ana e pushtetit ekzekutiv. Kuvendi, gjithashtu duhet t'i ndryshojë procedurat për miratimin e ligjeve dhe patjetër duhet të zhvillojë praksë të përputhshmërisë me Rregulloren.

Konkretisht, kjo mund të bëhet me këto hapa:

1. Aktivitete që kanë të bëjnë me transparencën dhe përfshirjen në punën e Kuvendit:

- Rritja e transparencës së punës të deputetëve, me qëllim rritjen e përgjithshme e transparencës së Kuvendit;
- Përforcimi i skemës së programit të kanalit të Kuvendit në kuadër të servisit publik radiodifuziv në drejtim të mundësimit të informacioneve me kohë për orarin e mbledhjeve dhe seancave të Kuvendit dhe të komisioneve, si dhe transmetimi i tyre të drejtpërdrejtë. Inçizime nga mbledhjet dhe seancat duhet të jenë në dispozicion në ueb faqen e Kuvendit;
- Shënimet e stenogramit nga mbledhjet e komisioneve duhet të jenë publike përmes ueb faqes së Kuvendit, siç është rregulluar aktualisht për seancat e Kuvendit. Dokumentet mbështetëse që kanë të bëjnë me propozim-ligjet (raporte, vlerësime, analiza) gjithashtu duhet të transferohen në ueb faqen e Kuvendit dhe duhet mundësuar që lehtësisht të kërkohen;
- Medoemos duhet të vendoset mekanizëm për përfshirje më thelbësore të palëve të prekura – veçanërisht nga sektori qytetar – përmes regjistrimit dhe akreditimit sipas fushave tematike;

- Pjesëmarrja e aktorëve nga shoqëria civile në fazat e hershme nga procesi ligjvënës patjetër duhet të jetë praksë e zakonshme. Kjo mund të bëhet përmes caktimit të të a.sh.q. debate të legjislacionit;
- Përcaktimi i orarit mujor apo kuartal për të gjitha aktivitete parlamentare, me qëllim që të mundësohet përfshirje më të lehtë të palëve të prekura në procesin ligjvënës. Oraret e tilla patjetër duhet plotësisht të respektohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Kuvend dhe Rregulloren e Kuvendit;
- Procedura për thirrjen e debatit mbikëqyrës duhet të thjeshtësohet. Duhet që dhjetë (10) në vend të pesëmbëdhjetë (15) deputetëve të mund të kërkojnë mbajtjen e debatit mbikëqyrës. Kryetari i trupit punues do të ketë si obligim thirrjen e menjëhershme të mbajtes së tij;
- Debatet publike duhet të reformohen dhe të jenë të domosdoshme në fillim të çdo procesi ligjvënës. Aktualisht, vendosja për nevojën e debateve publike është lënë në vullnetin e kryetarëve të komisioneve parlamentare.

2. Aktivitete që kanë të bëjnë me mekanizmat e kontrollit parlamentar:

- Kuvendi duhet të caktojë komision anketues, i cili në bazë të raportit të pavarur të ekspertëve do të jetë i detyruar që ta vlerësojë punën e funksionarëve aktualë nga trupat regullativë dhe mbikëqyrëse dhe që do të propozojë ndryshime eventuale në përbërjen kadrovike të këtyre trupave. Komisioni anketues duhet të propozojë masa eventuale dhe arsyetim të tyre, duke marrë parasysh qëllime legjitime dhe duke repsektuar parimin e proporcionalitetit;
- Raporte të jashtëzakonshme dhe trupa mbikëqyarëse të detyruara që të shqyrtojnë raste të mashtrimeve, klientelizmit mediatik dhe korrupsionit në nivel të lartë duhet të vendosen me kërkesë të Kuvendit. Kjo do ta përforconte rolin mbikëqyrës dhe kontrollues të Kuvendit ndaj këtyre trupave;
- Përforcimi i përbërjes së komisioneve parlamentare kompetente për kontroll në DSK dhe MBP me ekspertë dhe përfaqësues të shoqërisë civile në bazë të barabartë. Kjo do ta përforconte profesionalizmin dhe besueshmërinë në këto trupa;
- Përcaktimi i afateve të rrepta dhe pasojave për injorimin e rekomandimeve ose kërkesave të Kuvendit për DSK dhe MPB. E njëjta duhet të parashihet edhe për të gjitha institucionet e tjera që i nënshtrohen kontrollit parlamentar;
- Obligimi për pjesëmarrje në dëgjesat e organizuara në kuadër të debateve publike duhet të jetë i domosdoshëm. Gjithashtu, duhet të vendosen edhe mekanizma për informim nga debatet mbikëqyrëse;
- Debate hetuese duhet të vendosen që të përforcohen mekanizmat e kontrollit parlamentar;

- Rritja e llogaridhënjes së institucioneve përmes vendosjes së masave të shkarkimit të përfaqësuesve të institucioneve që nuk janë paraqitur tri here me ftesë të Kuvendit.

3. Aktivitete që kanë të bëjnë me procedurat për miratimin e ligjeve dhe efektiviteti i diskutimeve parlamentare:

- Vazhdimi i kohëzgjatjes ndërmjet fazave në procedurën për miratimin e ligjeve;
- Vendosja e kushtit prej 2/3 të shumicës për miratimin e ligjit me procedurë të shkurtuar, si dhe listë të akteve që nuk mund të miratohen në procedurë të shkurtëruar;
- Nevojitet reformë e anëtarësisë në komisionet parlamentare: zëvendësit e kryetarëve të trupave punuese duhet të jenë anëtarë të përhershëm të trupave. Aktualisht, zëvendësit e kryetarëve shpeshherë nuk janë anëtarë të pranishëm të komisioneve me të cilat udhëheqin në mungesë të kryetarit;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi mes Qeverisë dhe Kuvendit në fazat e hershme të përpilimit të ligjeve (Procedurë qeveritare) duhet të përforcohet në drejtim të mundësimit të informacioneve në kohë për deputetët në lidhje me propozimet qeveritare;
- Efektiviteti i shërbimit parlamentar duhet të vlerësohet dhe dobësitë eventuale duhet të adresohen. Plani për sistematizim të shërbimit parlamentar duhet evaluuar dhe përmirësuar;
- Kufizimi se deputeti gjatë dëgjimit mund të flasë vetëm njëherë duhet të fshihet nga Rregullorja;
- Duhet të mundësohet paraqitje për fjalim gjatë gjithë kohës së dëgjimit;
- Vazhdimi i kohës për parashtrimin e pyejteve të deputetëve dhe vendosja e mbledhjes të pyetjeve të deputetëve një herë në javë;
- Raporti midis kufizimit në diskutimet dhe koordinuesit të grupeve parlamentare duhet të jetë më i balancuar. Aktualisht, vetëm koordinatorët e grupeve parlamentare mund të flasin më shumë herë në kuadër të dëgjimit dhe në kohë më të gjatë.

INSTRUMENTET

1. Transparencë dhe përfshirje në punën e Kuvendit:

- Përhapja e informacioneve të deputetëve dhe punës së tyre në ueb faqen e Kuvendit:
  - biografi të deputetëve, informacione për kontakt, informacione financiare (rrogë, të dhëna për rrogën në bazë të anëtarësisë në komisione parlamentare, kompensim të shpenzimeve për transport dhe apartament, listë të anketuesve për gjendjen e pronës, deklaratë për interesa (lidhur me ueb faqen e KSHPK) [shembull: Parlamenti në Britaninë e Madhe dhe Kongresi i SHBA], evidencë për votim

(shembull: Parlamenti Evropian), pjesëmarrje në seanca parlamentare, fjalime në seanca parlamentare, hapësirë për arsyetim të mungesës nga seancat parlamentare, agjendë të mbledhjeve etj.

- Mundësimi i qasjes së hapur për qytetarët dhe organizatat qytetare;
- Ndryshimi i nenit 21 nga Ligji për Kuvend që të mundësohet (10) deputetë të mund të kërkojnë mbajtjen e debatit mbikëqyrës;
- Vendosja e dispozitës me të cilën debatet publike në kuadër të komisioneve parlamentare do të jenë të domosdoshme për fillimin e çdo procesi ligjvënës;
- Vendosja e dispozitave në Rregulloren që do ta rregullojnë funksionimin e kanalit të Kuvendit dhe ueb faqen e Kuvendit, në pajtim me parimet e lartëpërmendura: zhvillimi i skemës së programit të kanalit të Kuvendit, publikimi i inçizimeve nga seancat dhe mbledhjet e komisioneve dhe të Kuvendit në kanalin e Kuvendit dhe në ueb faqen e Kuvendit;
- Ndryshimi i nenit 107 të Rregullores me qëllim vendosjen e publikimit të domosdoshëm të shënimeve të stenogramit nga debatet e komisioneve në ueb faqen e Kuvendit;
- Vendosja e dispozitave në rregulloren me të cilin do të vendoset dhe rregullohet regjistrimi dhe akreditimi i palëve të prekura për pjesëmarrje në aktivitetet e Kuvendit;
- Vendosja e Rregullores që do të mundësojë krijimin e orarit të rregullt mujor/kuartal për aktivitetet e Kuvendit, siç është përshkruar më sipër.

2. Mekanizma për kontroll parlamentar:

- Vendosja e komisionit anketues i detyruar që ta vlerësojë punën e funksionarëve aktualë në trupat rregullative dhe mbikëqyrëse. Më tej Kuvendi duhet të veprojë në pajtim me konstatimet e këtij komisioni;
- Kuvendi duhet të marrë, me kërkesë të veten, raporte të jashtëzakonshme nga trupat rregullative dhe mbikëqyrëse të detyruar të shqyrtojnë raste të mashtrimeve zgjedhore, klientelizmit mediatik dhe korrupsionit në nivel të lartë. Këto raporte duhet të diskutohen në debate publike
- Përforcimi i përbërjes së komisioneve parlamentare kompetentë për kontroll të DSK dhe MPB me ekspertë dhe përfaqësues nga shoqëria civile në bazë të barabartë;
- Vendosja e afateve të rrepta dhe pasojave për injorimin e rekomandimeve ose kërkesave të Kuvendit drjetuar DSK dhe MBP;
- Vendosja e kornizës juridike për komisionet anketuese, duke përfshirë edhe rregullimin e pjesëmarrjes së domosdoshme të dëshmitarëve, vendosja e betimit për dëshmitarët dhe definimi i raportit mes hetimeve parlamentare dhe gjykatës;
- Deputetët duhet të kërkojnë përgjegjësi dhe dorëheqje nga funksionarët që refuzojnë të paraqiten për degjesë në kuadër të debatet mbikëqyrëse ose eventualisht hetuese;

- Vendosja e kornizës juridike që do ta stimulojë përgjegjësinë e udhëheqësve të institucioneve që nuk përgjigjen me praninë në debate me ftesë të Kuvendit.

3. Procedura për miratimin e ligjeve dhe efektiviteti i diskutimeve parlamentare:

- Ndryshime të Rregullores së Kuvendit të RM-së:
  - ndryshime të dispozitave që e caktojnë kohëzgjatjen e tri fazave në procedurën për miratimin e ligjeve, veçanërisht mes fazës së dytë dhe të tretë;
  - ndryshimi i nenit 171 me qëllim të vendosjes së kushtit prej 2/3 të shumicës për miratimin e ligjit me procedurë të shkurtuar, si dhe vendosja e listave të ligjeve që nuk mund të miratohen me procedurë të shkurtuar;
  - ndryshimi i nenit 80, paragrafi 2 me qëllim mënjanimin e dispozitës me të cilën rregullohet se deputetët paraqiten për fjalë në afat prej një minute pas fillimit të dëgjimit. Paraqitja për fjalë duhet të sigurohet gjatë gjithë kohës së dëgjimit;
  - ndryshimi i nenit 39, paragrafe 5 dhe 6 lidhur me kufizimet kohore të pyetjeve të deputetëve, si dhe neni 42, paragrafi 3 lidhur me keqpërdorimin e kohës të seancave plenare për prezantimin e përgjigjeve me shkrim nga seancat e mëparshme dhe për pyetje të parashtruara mes seancave. Kjo praktikë të përgjigjeve me shkrim e kufizon kohën për pyetje të reja të deputetëve dhe e keqëson raportin dy kundër një në dobi të deputetëve të opozitës (neni 40, paragrafi2).

INSTITUCIONET KRYESORE DHE ROLI I TYRE I MUNDSHËM

Të gjitha intervenimet janë në kuadër të organizimit të brendshëm të Kuvendit. Që këtu, Kuvendi është institucioni i vetëm, i cili do të duhej të punonte në zbatimin e masave të propozuara. Të gjitha partitë parlamentare dhe grupe parlamentare duhet haptazi t'i mbështesin intervenimet. Instituti parlamentar, organizatat qytetare dhe tink-tenqet që punojnë në mbështetje të punës së Kuvendit patjetër duhet t'i informaojnë deputetët për pasojat e intervenimeve të propozuara.

SHOQËRIA CIVILE

HYRJE

Për momentin, pjesëmarrja civile është shumë e margjinalizuat, si në procesin e hartimit të politikave, ashtu edhe në procesin politik. Kanali kryesor për përfaqësim të interesave individuale ose të grupit janë partitë politike, të cilat janë qendër e fuqisë politike dhe institucionale. Shoqatat joformale qytetare ballafaqohen me prag të lartë për iniciativë gjyqësore, referendum nacional ose lokal, iniciativa qytetare ose revokim të funksionerëve të zgjedhur. Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e mekanizmave dhe praktikave ekzistuese për konstultim të shoqërisë civile janë ose jofunksionale ose janë vetëm zyrtare. Në situate të këtillë, pjesëmarrja civile është e kufizuar dhe e pamjaftueshme, si në nivel themelor, ashtu edhe në nivel politik, gjë që lë hapësirë të gjërë për ndikim të rëndësishëm e cila vjen vetëm nga partitë politike dhe institucionet.

PARIME TË PËRGJITHSHME

- sigurim i një kornize ligjore për të drejtën e tubimit paqësor (të drejtën për të protestuar) në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe sigurim të implementimit efektiv të tij;
- përforcimin e demokracisë direkte dhe shoqatave jozyrtare civile përmes nxitjes së referendumeve lokale, inciativave legjislative dhe peticioneve;
- informim të qytetarëve për mundësitë dhe instrumentet për pjesëmarrje;
- krijimin e finansimit publik relevant (bazuar në nevoja), finansim transparent dhe të përgjegjshëm të shoqërisë civile dhe zhvillimit të saj;
- formimin e një Zyre të pavarur me kapacitete të plota dhe staf kompetent (Departamenti aktual për bashkëpunim me organizata joqeveritare në Sekretariatin gjeneral) me buxhet të ndarë dhe iniciativë legjislative;
- rishikim substancial të Strategjisë për bashkëpunim me sektorin civil të Qeverisë së RM-së, si dhe të Planit të veprimit;
- krijimi i një Këshilli të pavarur dhe reprezentativ për bashkëpunim me shoqërinë civile;
- krijimi i një mekanizmi efektiv konsultativ për hartim të politikave dhe miratim të ligjeve me garancë për përfaqësim civil në të gjitha fazat e hartimit të politikave;
- mbështetje të modeleve të vetë-organizuara të pjesëmarrjes civile me qëllim që të arrihet nivel më i lartë i pluralizmit dhe të stimulohet pjesëmarrja civile (p.sh. Këshilli nacional rinor, Parlamenti studentor, forma të vetë-organizimit në shkolla të mesme, etj.);
- sigurimin e një mjedisi të përshtatshëm për organizatat qytetare të cilat do të sigurojnë mbrojtje kundër gjuhës së urrejtjes, sulme personale ose forma të tjera të presionit të paligjshëm ose frikësimit

INSTRUMENTE

Urgjente

Ndryshime në ligjet përkatëse me qëllim që në mënyrë të ndjeshme të reduktohet pragu për referendum lokal, iniciativë legjislative dhe peticion.

Për këtë masë duhen ndërhyrje konceptuale dhe logjistike, duke e patur parasysh nivelin e ulët të qasjes në institucionet për regjistrim të qytetarëve të cilët duan të praktikojnë forma të këtilla të demokracisë së drejtpërdrejtë.

- Përveç në zyrat rajonale të KSHZ-së, të sigurohet mundësi për mbledhje të nënshkrimeve për referendum (lokal) edhe në hapësira publike (psh. shesh);
- Evaluim dhe, nëse është e nevojshme, rishikim të Ligjit për vetëqeverisje lokale me qëllim që të sigurohen mekanizma plotësues për demokraci direkte, përfshirë këtu edhe përfaqësues të shoqërisë civile në këshilla, përgatitje të strategjive lokale për bashkëpunim me shoqërinë civile së bashku me organizatat qytetare dhe sigurim të përkrahjes financiare dhe përkrahjeve të tjera për iniciativa të këtilla;
- Fushatë mediatike masive dhe interaktive për informim të qytetarëve për mundësitë për pjesëmarrje dhe njëkohësisht stimulim të aktivizmit.

Formimin e një Këshilli të pavarur dhe reprezentativ për bashkëpunim me shoqërinë civile

- Revizion të Vendimit për formim të Këshillit, në përputhje me propozimet nga organizatat qytetare të dhëna para miratimit, përfshirë edhe zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të sektorit civil nga ana e organizatave qytetare;
- Rol teknik të Departamentit në organizimin e zgjedhjes;
- Pozita kryetar dhe shumica e anëtarëve (14 në krahasim me 13) duhet të jenë nga shoqëria civile me çka do të tregohet vullnet dhe dëgjim politik për nevojat e shoqërisë civile;
- Buxhet, më së paku 4 seanca në vit, etj.

Sigurim i një kornize ligjore për të drejtën e tubimit paqësor (të drejtën për të protestuar) në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe sigurim të implementimit efektiv të tij

- tërheqje të ndryshimeve nga Ligji për polici nga marsi i vitit 2015 (4 mënyra të reja për shpërndarje të turmës dhe video inçizim) dhe kryerja e një hetimi të plotë, shqiptimi i masave disiplinore dhe publikim i gjetjeve nga përdorimi i tepruar i forcës nga ana e policies në protestën e mbajtur në datë 5 maj;

- monitorim i progresit në implementimin e masës për krijim të një zone neutrale rreth ndërtesës së Kuvendit të RM-së në Planin për aktivitete të Qeverisë së RM-së (pika 4.1), e përgatitur në bazë të Prioriteve urgjente për reforma të RM-së dhe duke i theksuar kufizimet e mundshme për të drejtën e tubimit paqësor;
- zbatim i plotë dhe jo-selektiv dhe respektim i të drejtës për tubim nga ana e institucioneve dhe policies, veçanërisht në raste të tubimit paqësor.
- Është e nevojshme të përforcohen kapacitetet e institucioneve dhe policies për përdorim të duhur të dhunës me qëllim të ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike, përfshirë edhe përgatitjen e udhëzimeve dhe trajnimeve bazuar në Rekomandimet praktike për menaxhim të tubimeve nga ana e raportuesve special të OKB-së Maina Kiai dhe Kristof Hejns (A/HRC/31/66), mars 2016.

Afatshkurte

Krijimin e finansimit publik relevant (bazuar në nevoja, finansim transparent dhe të përgjegjshëm të shoqërisë civile dhe zhvillimit të saj

- rishqyrtim dhe miratim të Propozim-vendimit për ndarje të mjeteve publike të destinuara për finansim të aktiviteteve programore të organizatave qytetare dhe fondacioneve nga v. 2014 (Linja buxhetore 463), përfshirë edhe definimin e një procedure dhe kriteri të qartë për ndarje të mjeteve (financim shumëvjeçar dhe financim institucional, projekte dhe bashkëfinancim të projekteve të huaja (BE);
- ndryshim të Nenit 16 nga Ligji për lojëra të fatit dhe lojëra argëtuese me qëllim që të futet konkurs publik i obligueshëm për ndarje të mjeteve dhe raport për mjetet e shpenzura;
- prezantim analitik të linjës buxhetore 463 deri 6 shifra në lidhje me transferet drejt organizatave qytetare dhe fondacionet përmes ministrive dhe agjencive, si dhe transferet drejt partive politike dhe organizatave të tjera.

Formimin e një Zyre të pavarur me kapacitete të plota dhe staf kompetent (Departamenti aktual për bashkëpunim me organizata joqeveritare në Sekretariatin gjeneral) me buxhet të ndarë dhe iniciativë legjislative;

- përmirësim të statusit të departamentit aktual në zyrën e pavarur në kuadër të Sekretariatit gjeneral, garantim të pavarësisë në veprimet e të punësuarve në komunikimin me organizatat qytetare, krijimin e një strategjije efektive komunikuese me organizatat qytetare/personat për kontakt në ministritë përkatëse, mbështetje të Këshillit për bashkëpunim me organizatat qytetare (Sekretariati i tij) dhe plotësim i Strategjisë, evaluimi i saj dhe përgatitje të masave strategjike në fushën e qëndrueshmërisë financiare (p.sh. lirim nga tatimi për persona fizik,

donim korporativ, status të interesit publik, aktivitete ekonomike, gjenerim të të ardhurave, volontim);
- sigurim të stafit plotësues (më së shumti deri në 5);
- sigurim të buxhetit të pavarur me qëllim që Zyra të mund ti kryejë detyrat e saj në mënyrë të pavarur dhe në kohë.

Rishikim të Strategjisë për bashkëpunim me sektorin civil të Qeverisë së RM-së, si dhe të Planit të veprimit me qëllim që të futen masa efektive për funksionim dhe zhvillim efektiv të shoqërisë civile

- dokument për hartëzim të gjendjes momentale të shoqërisë civile (numri i organizatave qytetare të regjistruara, aktive dhe joaktive) dhe definim të termit „mjedis të përshtatshëm" në kuptim më të gjerë për organizatat qytetare;
- përkrahje për të gjitha rrjetet ekzistuese efektive tematike të organizatave qytetare (Platforma për anti-korrupsion, IPA 2 mekanizëm për organizatat qytetare, Rrjeti 23, Këshilli nacional rinor, Qytetarët për Maqedoninë, Platforma për barazi gjinore, etj.) dhe transparenca e tyre e mëtejshme dhe të qenit të hapur ndaj anëtarëve të rinj;
- Vlerësim të Planit të veprimit aktual me përfshirje të shoqërisë civile dhe alokim të mjeteve buxhetore për realizim të aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë dhe për të gjitha institucionet kompetente shtetërore;
- Rishikim të masave në Planin e veprimit me qëllim që të sigurohet implementim i duhur dhe në kohë të masave ekzistuese dhe përmirësimin e masave të nevojshme përmes procesit inkluziv, duke i përfshirë palët e tanguara/organizatat kyçe qytetare (p.sh. grupi i kaluar i punës për përgatitje të Strategjisë).

Implementim konsistent, me kohë dhe të plotë të Metodologjisë për vlerësim të ndikimit të rregullores, përfshirë edhe konsultimet e obligueshme me shoqërinë civile

- Qeveria duhet t'i publikojë të gjitha konkluzionet nga seancat e saj, kurse nëse nëse kjo nuk është e mundur, për raste të caktuara të izoluara duhet të përgatisë kriteriume të qarta (p.sh. siguri nacionale);
- Qeveria duhet ta raportojë Planin e saj të punës 2017 deri në tremujorin e katërt të vitit 2016;
- Të gjitha ministritë duhet t'i publikojnë planet e tyre vjetore për vlerësim të ndikimit të rregullores në tremujorin e parë të vitit;
- Krijim i politikave bazuar në fakte, me analiza thelbësore të cilat do të përmbajnë implikime financiare;
- Publikim i plotë i planeve për përgatitje të politikave dhe propozim-ligjeve, si dhe vazhdim të kornizës kohore për konsultim të RVEN në më pak se 20 ditë;

- Futje të përgatitjes së obligueshme dhe miratimit të Raportit vjetor për konsultime, i cili do t'i përfshijë të gjitha elementet thelbësore (reagim nga palët e tanguara, përgjigje nga institucionet, propozime të pranuara/të refuzuara, arsye, etj.).

INSTITUCIONET KYÇE DHE ROLI I MUNDSHËM I TYRE

- Sekretariati gjeneral i Qeverisë – përgjegjës për Strategjinë për bashkëpunim me sektorin civil dhe dokumentet e tjera, si dhe për koordinim të kosultimeve në nivel të pushtetit ekzekutiv;
- Sekretariati për çështje evropiane- koordinim të finansimit dhe kornizës së BE-së
- Ministria për drejtësi – përgjegjëse për ligjet që kanë të bëjnë me iniciativat qytetare dhe kontributin direkt në demokraci;
- Komisioni shtetëror zgjedhor (shiko pikën e mëparshme për Ministrinë për drejtësi))
- Agjencia për rini dhe sport (reformë)
- Ministria për vetëqeverisje lokale

MBROJTJA SOCIALE, MIRËQENIA DHE QËNDRUESHMËRIA

Për ballafaqim me varfërinë, pabarazinë dhe sfidat me mjedisin jetësor është e nevojshme të shqyrtohen gabimet e sistemit ekzistues. Shumë është e rëndësishme që të njihen lidhjet kauzale mes politikave të përgjithshme ekzistuese të shtetit dhe pasojave që ato i kanë mbi varfërinë, pabarazinë, mirëqenien e përgjithshme dhe mjedisin jetësor, e pastaj të krijohet sistem i cili do të mund t'i trajtojë këto çështje.

Strategjitë e pjesshme të cilat e trajtojnë vetëm varfërinë, vetëm pabarazinë, vetëm ndotjen, vetëm çështjet etnike dhe/ose çështje të tjera, trajtojn vetëm një aspekt të problemit, kurse në këtë rast bëhet fjalë për çështje ndërsektoriale. Këto mund të jenë pasojë e: mungesa e sundimit të ligjit, institucionet jofunkcionale, korrupsioni i përhapur gjërë, sistemi i keq arsimor dhe shëndetësor, dobësitë e rregulloreve të qeverisë, keqpërdorimi i pushtetit të tregut të kompanive, mbrojtja e dobët e të drejtave të konsumatorëve, të drejtat e pakta të punëtorëve të cilat po shkurtohen akoma më shumë, sistemi regresiv i taksave, niveli i ulët i mbrojtjes sociale, etj. Veprimi i përbashkët i të gjitha këtyre dobësive sjell deri te niveli i lartë i varfërisë, pabarazia, ndotja e mjedisit jetësor dhe paqëndrueshmëria e përgjithshme.

Krijimin e një sistemi funksional me trajtim të të gjitha këtyre segmenteve të shoqërisë, padyshim që do ta rrisë mirëqenien e qytetarëve dhe do të çojë deri në zhvillim të qëndrueshëm. Për fat të keq, krijimi i këtij sistemi nuk është planifikuar asnjëherë në Maqedoni. Këto janë sfida të cilat qeveria eksperte nuk do të mund t'i tejkalojë gjatë mandatit të saj, si për shkak të mungesës së ohës, ashtu edhe për shkak të mungesës së legjitimitetit për detyrë të këtillë. Megjithatë, atë që mund ta bëjë kjo qeveri eksperte është që të inicojë diskutim për këto çështje dhe për atë se cila është strategjia më e mirë për zgjidhjen e tyre. Mund t'i marrë në konsideratë problemet, t'i shqyrtojë qasjet për ballafaqim me të njejtat dhe të propozojë një paketë masash potenciale.

Si parim, politika sociale duhet të ndërtohet përmes zgjidhjeve afatgjate, të qëndrueshme dhe sistematike, dhe jo përmes planeve afatshkurte të veprimit të cilat trajtojnë pjesë të caktuar të kategorive të ndryshme të shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale. Republika e Maqedonisë duhet ta respektojë dispozitën kushtetuese që e karakterizon atë si shtet social.
Duke e patur parasysh rëndësinë e instrumenteve për mbrojtje sociale dhe me qëllim që të parandalohet keqpërdorimi i transfereve sociale të ndara në formë të shërbimeve sociale për kryerje të presionit ndaj përdoruesve të këtyre shërbimeve, gjegjësisht keqpërdorim të transfere sociale për kryerje të presioneve ndaj përdoruesve gjatë kohës së fushatës zgjedhore, i propozojmë këto aktivitete:

AKTIVITETE DHE INSTITUCIONE KYÇE

Aktiviteti është i fokusuar në monitorim „në vendngjarje" të procedurave për alokim të transferet sociale. Këto aktivitete duhet të implementohet nga ana e Ministrisë për punë dhe politikë sociale dhe Ministrisë për shëndetësi. Aktivitetet duhet të zbatohen në bashkëpunim me organizatat qytetare dhe ekspertë. Ato duhet urgjentisht të fillojnë (do të ishte mirë nëse zbatohen në afat prej 2 muaj) nga ana e Qeverisë së ardhshme me kapacitet të plotë. Janë të nevojshme edhe ndryshime në ligje pas konstituimit të Kuvendit të ri dhe formimit të Qeverisë së re. Kompleksiteti i aktivitetit krijon nevojën për një kuadër të monitorimit e cila do të sigurojë raporte të rregullta për fazat e zbatimit.

- **Vlerësim dhe monitorim „në vendngjarje"**

Masa parashikon mekanizëm për monitorim të komisioneve për alokim të transfereve sociale në shkallë të parë dhe të dytë. Aktivitetet për monitorim të dhënies së transfereve sociale (psh. ndihma financiare sociale, kompensim për ndihmë dhe përkujdesje nga person tjetër, të drejtën e mobilitetit, verbëri dhe pamundësisë për dëgjim) do të sigurojnë transparencë dhe sundim të ligjit, trajtimin e barabartë të përdoruesve dhe kthimin e besimit dhe sigurisë në sistemin e mbrojtjes sociale. Aktivitetet do të përfshijnë organizata relevante qytetare dhe ekspertë nga kabineti i ministrit për punë dhe politikë sociale.

Aktiviteti do të ketë:

Ndikim direkt: mund të kontribojë drejt heqjes së pengesave për qasje drejt dhe përdorimit të transfereve sociale..

Ndikim indirekt: mund të ndihmojë në tejkalimin e frikës te përdoruesit e transfereve sociale se do ta humbin ndihmën nëse nuk votojnë për partitë në pushtet. Përveç kësaj, mund të kontribojë në ndryshim të sjelljes së përdoruesve.

ARSIMI DHE POLITIKAT RINORE

HYRJE

Rregullimi i tepërt i arsimimit, mungesa e analizave dhe konsultimeve me palët e tanguara rezultoi me futje të politikave arsimore shumë kontraverze të cilat kanë shumë efekte shkatërruese mbi cilësinë e arsimit në Maqedoni. Atmosfera e presioneve, kontrollave dhe gjobave në të gjitha nivelet arsimore kontriboi në frustrime te nxënësit, studentët, mësimdhënësit dhe prindërit dhe për mosbesim në institucionet arsimore. Politizimi dhe partizimi janë prezent në të gjitha nivelet arsimore si asnjëherë më parë. Kjo shihet edhe në zgjedhjen e drejtorëve të shkollave dhe përfaqësuesve të prindërve në këshillet e prindërve, si dhe në punësime, vlerësime dhe avancime të mësimdhënësve.

Qëllimi i testimit ekstern që ta kontrollojnë objektivitetin e vlerësimit të mësimdhënësve ka shumë efekte negative në progresin dhe arritjen e nxënësve, si dhe në rrogat dhe punësimet e mësimdhënësve. Ligjet e reja për mësimdhënës dhe akademitë për mësimdhënës e nënvlerësojnë arsimin e mëparshëm dhe japin hapësirë më të madhe për kontrollë shtetërore dhe partiake mbi punësimin e mësimdhënësve. Strategjia nacionale për arsimim të integruar nuk pati sukses që të japë rezultate pozitive. Ndarja e nxënësve sipas gjuhës së mësimit dhe segregacioni në ndërrime të ndryshme dhe shkolla me integrim të vogël apo pa asnjë integrim mes nxënësve nga komunitete të ndryshme etnike. Proceset paralele për përgatitje të dokumenteve strategjike nuk e trajtojnë arsimin në mënyrë holistike, si sistem të integruar. Trupat nacionale, komisionet, institucionet dhe agjencitë me mandate të cilat përputhen rezultojnë dështim të marrjes së përgjegjësisë për kontrollë të cilësisë së arsimit. Analizat tregojnë që në planprogramet dhe librat ekzistojnë gabime faktike, përmbajtje jokonsistente, si dhe diskurse ideologjike dhe etnocentrike.

Mosekzistimi i pavarësisë dhe profesionalizmit të Këshillit për akreditim dhe evaluim të arsimimit të lartë, së bashku me mosekzistimin e procedurave transparente të brendshme dhe të jashtme për kontrollë të cilësisë paraqesin pengesa serioze për cilësi në arsimin e lartë, veçanërisht në aspekt të rritjes së numrit të programeve studentore të disperzuara dhe institucioneve të reja (private dhe shtetërore) të arsimit të lartë.

PARIME TË PËRGJITHSHME

- Politikë arsimore transparente dhe inkluzive e cila në proceset në mënyrë aktive do t'i përfshijë të gjitha palët e tanguara (shkollat, mësimdhënësit, prindërit, nxënësit, organizatat qytetare, ekspertë);
- Para se të futen çfardo lloj reforma arsimore, testim të pilot-modelit dhe pilot-masave dhe vlerësim të efikasitetit të tyre;

- Depolitizim dhe departizim të arsimit me qëllim që të zvogëlohet presioni mbi mësimdhënësit dhe relaksim të atmosferës në institucionet arsimore;
- Autonomia universitare duhet të respektohet dhe garantohet ashtu siç është e paraparë me Kushtetutën e RM-së. Bashkë me këtë, duhet të garantohet pavarësia e Këshillit për akreditim dhe evaluim të arsimit të lartë, si parakusht për profesionalizim të trupit më të lartë nacional në arsimin e lartë;
- Programe inkluzive mësimore që do t'i respektojnë dallimet arsimore, të karakterit, sociale, etnike dhe kulturore të nxënësve dhe familjeve të tyre dhe të cilat janë të bazuara në drejtësi, respekim, mos-diskriminim, barazi dhe akses për të gjithë.

INSTRUMENTE

Urgjente

- Duhet të stopohet pregatitja e Programit nacional për zhvillim të arsimit dhe dokumenteve të tjera afatgjate, si për shembull Strategjia për arsimim ndërkulturor, deri sa të krijohen kushte për proces inkluziv dhe cilësor;
- Fshirje të të gjithë neneve në ligjet lidhur me arsimimin që kanë të bëjnë me dënime dhe gjoba për prindërit, mësimdhënësit dhe nxënësit;
- Tërheqje të Ligjit për mësimdhënës në shkolla fillore dhe të mesme dhe Ligjit për akademi për mësimdhënës;
- Testimi ekstern i nxënësve duhet të realizohet si pilot-projekt, notat e marra nuk duhet të shënohen në dëftesat e nxënësve, e as nuk duhet të ketë gjoba dhe shpërblime për profesorët;
- Inspektorati shtetëtor i arsimit duhet t'i përdorë plotësisht mekanizmat e tij për parandalim të keqpërdorimit të hapësirave shkollore dhe stafit për fushata zgjedhore;
- Rezultatet e zgjedhjeve jodemokratike dhe kontestuese për kryetar të Parlamentit studentor duhet të anullohen. Duhet të shpallen zgjedhje të reja, por vetëm pasi komisioni për ndryshim të Statutit të universitetit, i krijuar nga ana e senatit të Universitetit në kuadër të Universitetit të Kirilit dhe Metodit dhe e cila përbëhet nga profesorë dhe studentë, do të përgatisë propozim-ndryshime, dhe pasiqë të ndryshohet modeli zgjedhor dhe modeli i organizimit studentor;
- Duhet të reaktivizohen konsultimet për Ligjin për arsim të lartë me qëllim që të finalizohet puna e amendamenteve, përfshirë edhe palët tjera të tanguara, më konkretisht Plenumi studentor dhe organizatat dhe lëvizjet tjera të cilat merren me arsimin e lartë dhe të drejtat e studentëve;
- Kuvendi duhet ta tërheqë ligjin për themelim të universitetit të ri "Damjan Gruev". Duhet të ndalohet zgjerimi i mëtutjeshëm dhe disperzimi i institucioneve të arsimit të lartë;

- Nuk duhet të përgatiten plane të reja të veprimit për Strategjinë nacionale për të rinj 2016-2025 deri sa të krijohen kushte për revizion të hollësishëm të tyre në konsultim me shoqësinë civile;
- Deri më 15 shtator të vitit 2016 duhet të nominohet përfaqësues i shoqërisë rinore civile në Bordin drejtues të Zyrës rajonale rinore. Ky proces duhet të bëhet transparent dhe ta përfshijë shoqërinë civile.

Afatshkurtër

- Ndryshimi i neneve në ligjet për arsim fillor dhe të mesëm të cilat e rregullojnë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave shkollor, zgjedhjen e drejtorëve dhe punësimet e mësimdhënësve;
- Modeli për testim ekstern duhet të jetë objekt për revizion, konstultim dhe ndryshim;
- Në Ligjin për arsim të mesëm duhet të futet Organizim i nxënësve të shkollave të mesme si koncept- duhet të formohet grup i punës i cili do të përgatisë propozim-model për organizim efektiv rinor dhe pjesëmarrje në proceset për vendimmarrje.
- Duhet të futet pjesëmarrje demokratike e studentëve në institucionet e arsimit të lartë, kurse modeli ekzistues i organizimit studentor duhet të rishqyrtohet dhe të adaptohet me qëllim që të mundësohet pluralizëm;

Afatmesëm

- Në konsultimet me palët e ndryshme të tanguara, përfshirë edhe shoqërinë civile, duhet të përgatitet një dokument i vetëm gjithpërfshirës (strategji) i cila do t'i përfshijë masat e parashikuara për dokumente të veçanta;
- Në bazë të analizës gjithpërfshirëse duhet t'i përkushtohet vëmendje serioze revidimit dhe përgatitjes së planprogrameve dhe librave të reja, me qëllim të dekontaminimit të etnocentrizmit dhe ideologjizmit të vlerave demokratike;
- Identifikimi dhe propozimi i modeleve që do ta depolitizojnë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave shkollor;
- Futjen e konceptit për ndihmë të familjeve që kanë nevojë për ndihmë për fëmijët e tyre në aspekt të mësimit, materialeve mësimore, veshje dhe ushqim, nëse është e nevojshme;
- Futje të masave pozitive arsimore në aspekt të shpërblimeve dhe mirënjohjeve për nxënës dhe mësimdhënës;
- Fakultetet për mësimdhënës duhet të reformohen, të tërheqin studentë cilësor në profesionin mësimdhënës, duhet t'i harmonizojnë programet e tyre me programet e niveleve më të ulëta të arsimit, praktika e studentëve në shkolla duhet të japë kontribut për nxënësit dhe shkollat
- Futjen e modelit paralel dhe konsekutiv për arsim nismëtar të mësimdhënësve që do të bazohet në shkathtësitë e mësimdhënësve dhe

çdo fakultet për mësimdhënës duhet ta garantojë cilësinë e programeve dhe praktikave të tyre;

- Formimi i komisionit ekspert i cili do t'i vlerësojë programet e ofruesve të trajnimeve të mësimdhënësve;
- Sigurimi i mekanizmit për financim të mësimdhënësve në seminare, punëtori dhe trajnime, në përputhje me nevojat dhe problemet e identifikuara (veçanërisht lidhur me multikulturalizmin, drejtësinë sociale, përfshirjen, ekologjinë, etj.)
- Të rishikohen mekanizmat ekzistuese për kontrollë të cilësisë dhe të mendohet për formim të një trupi të ri që do të jetë përgjegjës për cilësinë e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- Raportet e jashtme të evaluimit integral të shkollave që e kryen Inspektorati shtetëror i arsimit duhet të publikohen dhe të jenë të disponueshme për publikun;
- Miratimi i ligjit të ri për kontrollë të cilësisë në arsimin e lartë që do të sigurojë që Këshilli i ri për akreditim dhe evaluim do të jetë agjenci tërësisht e pavarur dhe profesionale, si hap i parë drejt anëtarësimit të plotë në Asociacionin evropian të agjencive për kontrollë të cilësisë.

INSTITUCIONET KYÇE DHE ROLI I MUNDSHËM I TYRE

- Ministria për arsim dhe shkencë;
- Qendra shtetërore e provimeve;
- Institucioni shtetëror i arsimit;
- Byroja për zhvillim të arsimit;
- Këshilli për akreditim dhe evaluim të arsimit të lartë;
- Agjencia për rini dhe sport.

MJEDISI JETËSOR

HYRJE

Legjislacioni në fushën e mjedisit jetësor edhe pse është transponuar nga legjislacioni i BE megjithatë është larg nga implementimi i plotë (nevojitet një numër i madh i akteve nënligjore me qëllim të mundësimit të implementimit të plotë). Zhvillimi i qëndrueshëm dhe aksioni klimatik janë në nivel të ulët të agjendës politike, ndërsa strategjitë zhvillimore, planet dhe projektet zbatohen në mënyrë jotransparente, pa pjesmëarrjen e publikut dhe shpeshherë shkaktojnë dëme serioze mbi mjedisin jetësor.

PARIMET E PËRGJITHSHME

Parimet e përgjithshme për sigurimin e mbrojtjes të mjedisit jetësor dhe mirëqënies njerëzore janë këto:

- Demokracia në fushën e mjedisit jetësor (qasje në informacione, pjesëmarrje të publikut dhe qasje në drejtësi në miratimin e vendimeve për mjedisin jetësor);
- Transparenca dhe përgjegjësia në shpenzimin e parave publike;
- Vendosja e mbrojtjes së mjedisit jetësor lartë në agjendën politike, si parakusht për integrim në BE.

AKTIVITETET

- Përforcimi i shërbimit inspektues, me qëllim të parandalimit të ndotjes dhe krimit ekologjik në nivel qendror dhe lokal, si dhe përmirësimi i transparencës së punës të inspektimit. Rritja e kapaciteteve të inspektorateve lokale që të jenë në mundësi të ballafaqohen me ankesat në nivel lokal. Përmirësimi i kapaciteteve për monitorim të mjedisit jetësor dhe mirëmbajta e bazës adekuata të të dhënave.
- Ristruktuimi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Agjenci të Mjedis Jetësor me qëllllim që t'u jepet përgjigje shërbimeve të pavarura të cilat Ministria duhet t'i sigurojë lidhur me mbrojtjen e mjedisit jetësor (VNMJ - vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor, Direktiva për emisione industriale, dhënia e lejeve ekologjike, etj.)
- Revizioni i buxhetit për Agjencinë (e ardhshme) të Mjedisit Jetësor me qëllim të përgjigjes së nevojave reale për implementimin e legjislacionit. Taksat ekologjike (nga regjistrimi i automjeteve, cigaret, alkoolt, derivatet, ambalazhet plastike, gjobat etj.) patjetër duhet të grumbullohen dhe të menaxhohen nga Agjencia.
- Përfshirja e përfaqësuesve nga organizatat qytetare në grupe punuese (për përpilimin e ligjeve etj.) dhe komiteteve për përcjelljen e Ministrisë së Mjedisit Jetësor me qëllim të sigurimit të transparencës, përgjegjësisë dhe pjesëmarrjes së publikut. Përfshirja e përfaqësuesve nga organizatat qytetare në procesin e dhënies së projekteve të financuara nga programi

vjetor i Ministrisë (nga fondet publike). Përfshirja e organizatave qytetare, ekspertëve dhe aktorëve të tjerë joshtetëror në planifikimin urbanistik.

- Informimi i rregullt i publikut për problemet në mjedisin jetësor, niveli i ndotjes dhe burimet e ndotjes, mirëmbajta e regjistrit adekuat në dispozicion të publikut për ndotësit. Informimi i publikut për mënyrën e menaxhimit me hapësirat publike dhe sipërfaqet e gjelbërta në nivel lokal dhe përfshirja e publikut në zhvillimin e hapësirave publike.
- Reformat dhe ristruktuimi i Ndërmarrjes Publike Pyjet e Maqedonisë, në kuptimin e sistemit të certifikuar për ndjekjen e ekonomisë së pyjeve, gjithashtu zgjedh probleme me mbipunësimin dhe përgjegjësitë.

INSTRUMENTET

- Ministria e Financave duhet të përpilojë ndryshim të ligjit për buxhet për të vendosur sistem për grumbullimin e të gjitha taksave ekologjike që ato të mund të menaxhohen nga Agjencia e Mjedisit Jetësor, në pajtim me parimin "ndotësi paguan" dhe "konsumatori paguan", e jo të hyjnë në buxhetin qendror.
- Të bëhen ndryshime në ligjin për mjedis jetësor ku Ministria e Mjedisit Jetësor do të transferohet në Agjenci të Mjedisit Jetësor.
- Miratimi i politikave të reja për ruajtjen, mbrojtjen dhe rehabilitimin e fushave të gjelbërta urbane, si dhe krijimin e të rejave. Hartimi i planeve për uljen e ndikimeve negative të zhvillimit urban.
- Krijimi i trupave multisektoriale, inter-ministrore që të ballafaqohen me zhvillimin e qëndrueshëm dhe zbatimi i strategjive në bashkëpunim dhe koordinim të përbashkët.
- Identifikimi i zonave të ndaluara për projekte urbane dhe infrastrukturore. Miratimi i Strategjisë për biodiversitet.
- Implementimi i drejtë dhe i plotë i Direktivës për emisione industriale dhe Direktivës për përgjegjësi gjatë dëmeve ekologjike, me qëllim që t'i mundësohet Agjencisë së Mjedisit Jetësor (Ministrisë) financiarisht të jetë e aftë për zbatimin e teknikave më të mira.
- Planifikimi i zhvillimit dhe krijimi i strategjive në pajtim me objektivat e BE për efikasitet energjetik, përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë dhe mbrojte të klimës, si dhe respektimi i konventave ndërkombëtare (Konventa e Ahrhusit, Konventa e Bernit dhe Marrëveshja e Parisit) si dhe e drejta e BE. Miratimi i politikave të rrepta për kompensimin e humbjeve të biodiversitetit (Biodiversity offsetting), si masë përfundimtare për zbutjen e ndikimeve negative mbi mjedisin jetësor.

INSTITUCIONET KRYESORE

- Ministria e mjedisir jetësor dhe planifikimit hapësinor
- Agjencia e planifikimit hapësinor
- Ministria e financave
- Komunat

- Ndërmarrja publike pyjet e Maqedonisë

ANEKS 1- LISTA E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE DHE EKSPERT TË PËRFSHIRË NË INICIATIVË

A) Grupi kryesor

Asocacioni Qytetar MOST
Instituti për demokraci „Societas Civilis"
Instituti për Politikë Evropiane
Instituti për studime të komunikimit
Qendra maqedonase për arsimim evropian
Fondacioni Shoqëri e hapur - Maqedoni
Komiteti maqedonas i Helsinkit
Qendra për analiza ekonomike
CIVIL – Qendra për liri
Branimir Jovanoviq
Dragan Gocevski

B) Organizata të shoqërisë civile dhe ekspert të përfshirë sipas sektorëve

Financat publike dhe ekonomia
Qendra për analiza ekonomike
Branimir Jovanoviq
Petar Goshev
Nikola Popovski
Goran Petrevski
Abdylmenaf Bexheti
Shoqata e analistëve dhe hulumtuesve të rinj

Gjyqësori
Komiteti maqedonas i Helsinkit
Fondacioni Shoqëri e hapur - Maqedoni
Instituti për të drejtat e njeriut

Lufta kundër korrupsionit
Instituti për demokraci „Societas Civilis"
Fondacioni Shoqëri e hapur - Maqedoni
Transparensi interneshënël
Transparenca Maqedoni
Qendra maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar

Zgjedhjet dhe sistemi zgjedhor
Asocacioni Qytetar MOST
CIVIL – Qendra për liri

Mediat
Instituti për studime të komunikimit
Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë
Sindikati i gazetarëve dhe punëtorëve medial
Instituti maqedonas për media
Këshilli për etikë në media

OJQ Infoqendra
Qendra për zhvillim të mediave
Promedia
Sefer Tahiri
Vesna Shopar

Administrata publike
Instituti për Politikë Evropiane
Dragan Gocevski
Branimir Jovanoviq
Qendra për menaxhim me ndryshime
Metodija Dimovski

Kontrolli mbi policinë dhe agjencitë për siguri dhe (kundër)zbulim
Qendra maqedonase për arsimim evropian
Komiteti maqedonas i Helsinkit
Gordan Kalajxhiev
Forumi – Qendra për hulumtim strategjik dhe dokumentim (Forumi-QHSD)
Forumi për hulumtime të politikave të sigurisë - Sekuritas

Kuvendi
Instituti për demokraci „Societas Civilis"
Fondacioni Shoqëri e hapur – Maqedoni
Asocacioni Qytetar MOST

Shoqëria civile
Qendra maqedonase për arsimim evropian
Forumi rinor arsimor
Rrjeti ballkanik për zhvillim të shoqërisë civile
Qendra maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar
Marjan Zabrçanec

Mbrojtja sociale, mirëqenia dhe qëndrueshmëria
Dragan Gocevski
Marjan Nikolov
Branimir Jovanoviq

Arsimi dhe politikat rinore
Fondacioni Shoqëri e hapur - Maqedoni
Forumi rinor arsimor

Mjedisi jetësor
Eko-vetëdije
OhridSOS
Front 21/42
EkoGuerilla

ANEKS 2 - MASA TË PROPOZUARA LEGJISLATIVE

FUSHA	Ligji	Institucionet përgjegjëse shtetërore	Afati	Përmbajtja
Gjyqësori	Ndërprerje të Ligjit për Këshillin për verifikim të fakteve dhe ngritje të procedurës për vërtetim të përgjegjësisë për gjykatës (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 20/2015)	MD	Shkurtër	Tërheqje të ligjit
Gjyqësori	Ndërprerje të Ligjit për përcaktim të llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 199/2014)	MD	Shkurtër	Tërheqje të ligjit
Gjyqësori	Ndryshim të Ligjit për gjykatësit (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 61/2008, 118/2008, 16/2009, 150/2009, 150/2010 dhe 39/2012)	MD	Shkurtër	Ndryshime me të cilat do të formohet njësi e veçantë në kuadër të Gjykatës Themelore Shkup 1 – Shkup, e cila do të jetë përgjegjëse për përndjekje të veprave penale lidhur dhe që rezultojnë me përgjimin e paligjshëm të komunikimeve
Gjyqësori	Ndryshime në Ligjin për Prokurori publike për përndjekje të veprave penale lidhur dhe që rezultojnë nga përmbajtjet e përgjimit të paligjshëm të komunikimeve (Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 159/2015)	MD	Shkurtër	
Gjyqësori	Ndryshim të Ligjit për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 60/2006, 69/2006, 150/2010, 100/2011, 20/2015 dhe 61/2015)	MD	Shkurtër	Veçanërisht Neni 11 dhe 26
Gjyqësori	Ndryshim të Ligjit për Akademinë për gjykatës dhe prokurorë publik (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 20/2015, 192/2015 dhe 231/2015)	MD	Mesëm	Veçanërisht Neni 57
Gjyqësori	Ndryshim të Ligjit për Këshillin e prokurorëve publik (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 150/2007 dhe 100/2011)	MD	Mesëm	Përforcim të kritereve veçmë të vendosura për zgjedhje të anëtarëve të Këshillit të prokurorëve publik nga ana e Kuvendit (4 anëtarë) nga rradhët e “avokatë eminent”

Gjyqësori	Ndryshim të Ligjit për gjykatësit, neni 45 (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 61/2008, 118/2008, 16/2009, 150/2009, 150/2010 dhe 39/2012)	MD	Mesëm	Anëtarët e Këshillit gjyqësor punojnë edhe si gjykatës - Anëtarët e KGJ i plotësojnë kushtet për avokatë eminent
Lufta kundër korrupsionit	Ndryshime në Ligjin për mbrojtje të denoncuesve	MD	Shkurtër	Ndryshime në anëtarët të cilët e rregullojnë që gjykata mund t'a zbulojë identitetin e denoncuesve; Akte nënligjore të cilat duhet t'i rrisin standardet teknike për mbrojtje të identitetit të denoncuesve
Lufta kundër korrupsionit	Ndryshime në Ligjin për parandalim të korrupsionit	MD	Shkurtër	1. Ligji për parandalim të korrupsionit parashikon ekspertizë, përvojë dhe teste për integritet si parakusht për anëtarët e KSHPK 2. Ligji definon që organizatat qytetare me ekspertizë të vërtetuar në parandalim të korrupsionit u parashtrojnë pyetje të gjithë kandidatëve të KSHPK në debat publik në Kuvendin e RM-së.
Lufta kundër korrupsionit	Ndryshime në Ligjin për mbrojtje të dëshmitarëve	MD	Shkurtër	Mundësi për PPS që ta shfrytëzojë instrumentin
Lufta kundër korrupsionit	Ndryshime në Ligjin për finansim të partive politike	MD	Shkurtër	Ligji duhet të ndryshohet në bazë të dialogut për model të ri mes partive politike, organizatave qytetare dhe grupit të punës të KSHPK, DHP dhe ESHR në bazë të gjetjeve të publikuara në analizën e shkurtër.
Lufta kundër korrupsionit	Ndryshime në Ligjin për furnizime publike	MF	Shkurtër	Tërheqja e Neneve nga Ligji që e themelojnë Këshillin për furnizime publike dhe shpërbërja e anëtarëve të Këshillit; Revidimi i të ashtuquajturave referenca negative të kompanive Të rimendohet përdorimi i çmimit më të ulët si kriter i vetëm. Sipas direktivës së BE "oferta më e volitshme ekonomike" është caktuar si kriter kryesor i përbër nga më shumë elemente, ku përveç çmimit, qëndrojnë edhe cilësia dhe pagueshmëria e çmimit.
Zgjedhje	Ndryshime në Kodin zgjedhor	MD	Urgjent	* Ndryshime në përbërjen e KKZ dhe KZ: 1 anëtar nga administrata dhe 2 anëtarë nga partitë në pushtet dhe partitë opozitare * Zgjedhje të sekretarit gjeneral (drejtorit ekzekutiv) nga shërbimi profesional i Kuvendit me 2/3 shumicë; * Transferim të të gjitha kompetencave në drejtim të implementimit, duke e përfshirë edhe krijimin e Listës zgjedhore, të shërbimit profesional. Aktivitetet dhe dokumentet të cilat rezultojnë nga kompetencat e shërbimit profesional nuk duhet të jenë subjekt i miratimit/votimit nga ana e anëtarëve të KSHZ-së * KKZ duhet të përfshihen në procesin e pastrimit dhe hartimit të Listës zgjedhore.
Zgjedhje	Ndryshime në Kodin zgjedhor	MD	Shkurtër	* Ndryshime lidhur me votimin në diasporë dhe rregullimin e fushatës zgjedhore
Zgjedhje	Ndryshime në Kodin zgjedhor	MD	Mesëm	* Futjen e listave të hapura në kuadër të sistemit proporcional zgjedhor
Zgjedhje	Ndryshime në Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative	MD	Shkurtër	* Shkurtim i afateve për dorëzim të vendimit për anullim të vendbanimit, për dorëzim të ankesës pas vendimit, si dhe për vendimmarrje pas ankesës.

Zgjedhje	Ndryshime në Ligjin për konteste administrative	MD	Shkurtër	Shkurtim i afateve për fillim të kontestit administrativ kundër vendimit pas ankesës për anullim të vendbanimit, si dhe për dorëzimin e përgjigjes nga i pandehur; Futjen e afateve për miratimin e një verdikti pas ankesës, dorëzimin e ankesës kundër verdiktit dhe vendimmarrje pas ankesës.
Media	Ndryshime në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele	MSHIA	Urgjent	Ndalesë të çdo „publiciteti shtetëror“ në mediat elektronike komerciale dhe definim të qartë të terminit „Fushatë publike“. Përveç kësaj, duhet në mënyrë të qartë të definohen kushtet mbi të cilat fushatat publike mund të emitohen në shërbimin e transmetimit publik; Ndalesë të çdo reklame partike-politike gjatë periudhës së procesit zgjedhor edhe jashtë tij. Duhet të lejohet reklamim papagesë në SHTP në kushte të barabarta për të gjitha subjektet politike; Ndryshimi në strukturën për vendimmarrje dhe mënyrës së nominimit dhe zgjedhjes së anëtarëve të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, me qëllim të depolitizimit të saj; Ndryshim të përbërjes dhe kompetencave të Këshillit të programit të RTM-së me qëllim të depolitizimit të këtij trupi, profesionalizimit të tij dhe përforcimit të marrëdhënies së SHTP-së dhe shoqërisë civile; Ndryshime në financimin e SHTP-së, me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëri afatgjate dhe autonomi institucionale; Fshirje të dispozitave lidhur me „kuotën kulturore“ për produkcionin vendor dokumentar dhe artistik për mediat televizive nacionale, dispozitat që lidhen me fondet e Buxhetit të destinuara për produkcion të tillë, si dhe gjobat për shkeljen e këtyre dispozitave; Vendosjen e dispozitave për sanksionimin e gjuhës së urrejtjes apo nxitjen e dhunës në programe audiovizuele (neni 48 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele) në procedura penale; trupat rregullatore në të gjitha shtetet evropiane mund të ngrisin procedurë për shkelje dhe të shqiptojnë gjoba për emitim të gjuhës së urrejtjes. Dispozitat e këtilla janë në përputhje me nenin 10 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.
Administrata publike	Udhëzime për mekanizma për parandalim të keqpërdorimeve të shtetit për qëllime partiake	Qeveria e R.M.; Grupi punues për parandalimin e korrupsionit	Urgjent	Udhëzimet duhet të përmbajnë përshkrime të hollësishme për zbatim të predispozitave ligjore përkatëse të ligjeve dhe rregulloreve nënligjore përkatëse - Ligji për zyrtarë administrative, Kodi zgjedhor dhe ligje tjera;
Administrata publike	Ndryshime në Ligjin për qasje të lirë deri në informacione me karakter publik (Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 13/2006, 86/2008, 6/2010, 42/2014, 148/2015)	MD, Komisioni për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik	Mesëm	Të mundësohet që KMDQLIKP të ngre procedurë kundërvajtëse për posedues të informacioneve që nuk veprojnë sipas kërkesave; Të vendoset kompetencë për Komisionit për publikim dhe deklasifikimin e informacioneve të kategorizuara si të "brendshme" për qëllime të ruajtjes së interesit publik siç janë të definuara në Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve;

Administrata publike	Ndryshime në Ligjin për zyrtarë administrativ	MSHIA	Shkurtër	Të futen dënime më të ashpra, veçanërisht zyrtarëve administrativ, në lidhje me ndalesën për aktivitete partiake edhe gjatë periudhës së zgjedhjeve;
Administrata publike	Ndryshime në Ligjin për zyrtarë administrativ	MSHIA	Mesëm	Kthim të formatit të komisioneve disiplinore në tri anëtarë dhe caktim të përgjegjësisë më të madhe të njësive të burimeve njerëzore në procedure disiplinore
Administrata publike	Drejtësi e butë - si psh. udhëzime për dhënie të dënimeve	QRM	Shkurtër	Të sigurohet që gjobat administrative (shkeljet) janë mjeti i fundit; fokusi duhet të jetë në parandalim dhe jo në represion;
Policia dhe agjencitë për siguri dhe (kundër)zbulim	Lex specialis për kontrollë të jashtme mbi policinë ose ndryshime në Ligjin për policinë	MPB, MD	Urgjent	Mekanizmi i ardhshëm për kontroll të jashtëm mbi policinë do të përfshijë anëtarë të organizatave qytetare, universiteteve, prokurorive publike dhe nëpunës policie të pensionuar – në bazë të barabartë, me përgjegjësi dhe obligime të barabarta Puna e grupit të punës së ekspertëve e përkrahur nga Këshilli i Evropës dhe MPB-së duhet të përkrahet dhe të përshpejtohet
Kuvendi	Ndryshime në Ligjin për Kuvend	Kuvendi	Urgjent	− Neni 21 të mundësojë që 10 deputetë të mund të kërkojnë mbajtjen e debatit publik; − Shtim të anëtarëve për raportet e funksionerëve të cilët nuk do të paraqiten në marrje në pyetje me ftesë të Kuvendit; − Shtim i anëtarëve për debate hetimore; − Shtim të anëtarëve për komisione anketuese.
Kuvendi	Ndryshime në Rregulloren për punë në Kuvend	Kuvendi	Urgjent	− Shtim i anëtarëve për regjistrim dhe akreditim të palëve të jashtme të tanguara
Kuvendi	Ndryshime në Rregulloren për punë në Kuvend	Kuvendi	Shkurtër	− Vendosjen e debateve publik në fillim të procedurës gjyqësore (dëgjime legjislative); − Plotësime të dispozitave për kanalin dhe ueb faqen e Kuvendit.
Kuvendi	Ndryshime në Rregulloren për punë në Kuvend	Kuvendi	Shkurtër	− Neni 107 të përfshijë publikimin e domosdoshëm të shënimeve të stenogramit nga seancat e komisioneve ; − Të shtohen dispozita që do të vendosin orarin e rregullt periodik të aktiviteteve të Kuvendit
Kuvendi	Ndryshime në Rregulloren për punë në Kuvend	Kuvendi	Mesëm	− Neni 171 për procedurë të shkurtuar; − Ndryshime të dispozitave që e caktojnë kohëzgjatjen e tri fazave në procedurën për miratimin e ligjeve
Kuvendi	Ndryshime në Rregulloren për punë në Kuvend	Kuvendi	Mesëm	− Neni 39, paragrafi 5 dhe 6 për pyetje parlamentare; − Neni 42, paragrafi 3 për përgjigje të shkruar të pyetjeve parlamentare; − Neni 80, paragrafi 2, për mundësitë për paraqitje për diskutim; − neni 86, paragrafi 1, dispozita për „një fjalim të deputetit për pikë të rendit të ditës“
Shoqëria civile	Ndryshime në Ligjin për referendum dhe forma të tjera për shprehje të drejtpërdrejtë të qytetarëve (Gazeta zyrtare nr. 81/2005)	MD, MVL	Urgjent	Ndryshime në ligjet përkatëse me qëllim që në mënyrë të ndjeshme të reduktohet pragu për referendum lokal, iniciativë legjislative dhe peticion. Neni 3
Shoqëria civile	Ndryshime në Ligjin për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare nr. 02/2002)	MD, MVL	Urgjent	Ndryshime në ligjet përkatëse me qëllim që në mënyrë të ndjeshme të reduktohet pragu për referendum lokal, iniciativë legjislative dhe peticion. Neni 25-28

Shoqëria civile	Ndryshime në Ligjin për organizime studentore	MD, MASH, Agjencia për rini dhe sport	Shkurtër /mesëm	Ligj i ri i cili do ti ridefinojë parlamentet studentore
Shoqëria civile	Ndryshime në Ligjin për organizime rinore	MD, MASH, Agjencia për rini dhe sport	Shkurtër /mesëm	Ligj i ri i cili do të merret me këshillet lokale rinore, duke e pranuar Këshillin nacional rinor si organ përfaqësues zyrtar i përkrahur nga Forumi rinor evropian, etj.
Shoqëria civile	Strategji për bashkëpunim me shoqërinë civile	Sekretari gjeneral i Qeverisë, SÇE	Urgjent	Krijimi i një Këshilli të pavarur dhe reprezentativ për bashkëpunim me shoqërinë civile (Duke e ridefinuar Këshillin e sapokrijuar sipas rekomandimeve të përgatitura nga organizatat qytetare të cilat punojnë në fushat e mjedisit më të përshtatshëm për punë të SHC)
Shoqëria civile	Ligji për polici	MPB	Urgjent	Tërheqje të ndryshimeve të Ligjit nga marsi 2015 (4 masa të reja për inçizim dhe shpërndarje të turmës)
Arsimi dhe politikat rinore	Ligji për arsim fillor	MASH	Urgjent/shkurtër	Të tërhiqen të gjitha Nenet lidhur me gjoba dhe shpenzime për prindërit, mësimdhënësit dhe nxënësit;Të ndryshohen Nenet lidhur me testim ekstern ;Të ndryshohen Nenet që e rregullojnë zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit shkollor, zgjedhjen e drejtorëve të shkollave dhe zgjedhjen dhe punësimin e mësimdhënësve
Arsimi dhe politikat rinore	Ligji për arsim të mesëm	MASH	Urgjent/shkurtër	Të tërhiqen të gjitha Nenet lidhur me gjoba dhe shpenzime për prindërit, mësimdhënësit dhe nxënësit; Të ndryshohen Nenet që e rregullojnë zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit shkollor, zgjedhjen e drejtorëve të shkollave dhe zgjedhjen dhe punësimin e mësimdhënësve Të ndryshohen Nenet për organizime dhe pjesëmarrje të nxënësve Të ndryshohen Nenet lidhur me testim ekstern ;
Arsimi dhe politikat rinore	Ligji për akademi të mësimdhënësve	MASH	Urgjent	Të shfuqizohet
Arsimi dhe politikat rinore	Ligji për mësimdhënësit në shkollat fillore dhe të mesme	MASH	Urgjent	Të ndryshohet
Arsimi dhe politikat rinore	Ligji për arsim të lartë	MASH	Mesëm	Të miratohet Ligj i ri për arsim të lartë
Arsimi dhe politikat rinore	Ligji për themelim të Universitetit për siguri, mbrojtje dhe paqe nacionale „Damjan Gruev“ Shkup	MASH	Urgjent	Të tërhiqet
Mjedisi jetësor	Ligji për mjedisin jetësor	MAJPH		Të themelohet Agjenci për mjedis jetësor si zëvendësim për Ministrinë
Mjedisi jetësor	Ligji për Buxhet	MF		Të miratohen ndryshime që do të mundësojnë mbledhje të gjitha taksive për mjedis jetësor për qëllimet e Agjencisë për mjedis jetësor